

Majlinda Hala

Libër për mësuesin/en

Edukatë muzikore **3**



Libër për mësuesin/en

Edukatë muzikore **3**

ISBN: 978-9951-786-98-0



9

789951 786997

BOTIME

pegi

Dr. Majlinda Hala

LIBËR PËR MËSUESIN/EN

EDUKATË MUZIKORE 3

Për klasën e tretë të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



Prishtinë, 2023



BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTI-t:
Korrektore letrare: Orjada DAJKO
Paraqitja grafike dhe kopertina: Florinda Zonja
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-786-98-0

© Botime Pegi sh.p.k, dega në Kosovë, gusht 2023
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: cel: +355 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355 069 20 267 73; 069 40 106 88;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

PËRMBAJTJE

HYRJE.....	5
PLANI VJETOR.....	11
PLANI MËSIMOR: SHTATOR-TETOR; NËNTOR-DHJETOR.....	13
PLANI MËSIMOR: JANAR-SHKURT-MARS.....	20
PLANI MËSIMOR: PRILL-MAJI-QERSHOR.....	26
PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE.....	32
REFERENCA.....	93

I. Hyrje

Fëmija krijon kontaktet e para me muzikën që në moshë të hershme, fillimisht në rrethin familjar e pastaj edhe përmes edukimit muzikor në institucione shkollore. Ata vazhdimisht këndojnë, dëgjojnë muzikë në rrethin ku jetojnë, dëgjojnë zërat në natyrë, onomatopetë e ndryshme ritmike dhe melodike etj. Këto përvoja të hershme mund të përdoren për edukimin muzikor në klasën e tretë duke i konkretizuar këto përjetime nga jeta e përditshme me lojëra, këngë, ligjërime ritmike, lëvizje etj. Përmes aktivitetit muzikor, te fëmijët sjellim gëzim, hare, relaksim, entuziazëm. Në këtë mënyrë, muzika ndikon direkt në pasurimin emocional të tyre, i fisnikëron ata dhe njëkohësisht ndikon në zhvillimin e dispozitave të ndonjë prej aftësive muzikore për të cilën mund të ketë predispozitë.

Në klasën e tretë, lënda “Edukatë muzikore” ka për qëllim që të nxitë nxënësit/et ta duan muzikën si veprimtari dhe, që përmes aktiviteteve muzikore në klasë, të identifikojë e të zhvillojë më tutje predispozitat muzikore të nxënësve (për këndim, luajtje në instrumente ose reagim ndaj muzikës) në aftësi konkrete muzikore të nxënësve. Mësimi në shkollë bëhet më atraktiv dhe më i kënaqshëm përmes aktiviteteve të ndryshme artistike, në të cilat ata nxiten që të marrin pjesë. Synimi kryesor në këtë klasë është që nxënësit/et të nxiten të përjetojnë veprat artistike muzikore (këngë, pjesë instrumentale etj.) dhe të fillojnë të identifikojnë interesin e tyre për ndonjë nga veprimtaritë apo shkathtësitë artistike (këndim, krijime pamore, ritmizim, lëvizje etj.). Këto aktivitete nxitin zhvillimin emocional, intelektual, imagjinatën, vëmendjen, interesimin për kreativitet etj.

II. Format e punës për planifikimin dhe zhvillimin e muzikës

Planifikimi i punës mësimore dhe procesi i mësimdhënies është një moment/fazë e cila kërkon t’i japë njohuritë e duhura nxënësve, të nxisë nevojat e tyre, interesat dhe mënyrat e tyre të të mësuarit. Procesi mësimor do të ketë rezultate nëse nxënësit/et janë të nxitur për të nxënë dhe ku secili nxënës mëson sipas një mënyre të caktuar apo të njohur në literaturën pedagogjike si *stile të të nxënësve*. Disa nxënës mësojnë përmes *perceptimit*, të tjerë mësojnë duke *analizuar apo reflektuar*, disa përmes *të parit dhe të dëgjuarit*, disa mësojnë vetëm, të tjerë mësojnë në grupe, disa mësojnë në tërësi përmbajtjen mësimore, ndërsa të tjerë e ndajnë atë në pjesë më të vogla logjike.

Krahas këtyre përcaktimeve të të nxënësve, janë mësimdhënësit, të cilët gjatë përdorimit të strategjive dhe metodave në procesin mësimor, nxjerrin në pah artin dhe mjeshtërinë e tyre, por edhe vënë në zbatim përmes stileve të të nxënësve këto metoda.

Mësimdhënësi të caktuar përdorin më shumë demonstrimin, të tjerë ligjërimin, reflektimin, diskutimet, por ka të atillë që përqendrohen më shumë në të menduarit, në të kujtuarit, në të kuptuarit. Për të arritur suksese në procesin mësimor duhet patjetër që mësimdhënësi/ja t’i zbatojë stilet e të nxënësve, duke njohur më parë mënyrat se si mësojnë nxënësit/et, pikëmbështetje për planifikimin e punës mësimore, përputhshmërisë së stileve të të nxënësve dhe përdorimit të metodave apo teknikave të mësimdhënies në varësi të stileve të përdorura. Stilet e të nxënësve, nëpërmjet metodave dhe teknikave të mësimdhënies përmbush detyra të rëndësishme të mësimdhënies dhe:

- ruan *përfshirjen aktive*;
- nxit *diskutim të hapur*;

- nxit nxënësit/et të krijojnë dhe të bëjnë pyetjet e tyre;
- ndihmon shprehjen e mendimeve të nxënësve;
- ruan motivimin e nxënësve për të mësuar;
- siguron një mjedis ku respektohen mendimet;
- krijon një shtresë për reflektim në atë që nxënësit/et vlerësojnë;
- shërben si nxitje për ndryshim;
- vendos shpresë për përfshirjen kritike të nxënësve;
- ndihmon mendimin kritik në nivele të larta e të ndërlikuara.

Disa nga stilet e të nxënësve, më të përdorshmet në lëndën “Edukatë muzikore”

Stili i të nxënësve pamor, është kur nxënësi/ja e përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së të parit. Në këtë rast, mësimi konkretizohet, duke përdorur mjete mësimore si: *foto, harta, fotografi, grafikë, piktura, ngjyra, makete, ilustrime, vizatime, DVD (ku kemi dy lloj stilesh pamore dhe dëgjimore)* etj. Të nxënësve përmes të parit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi/ja ku kërkohet përqendrimi i nxënësve në:

- vëzhgimin e materialeve të vendosura për të memorizuar apo për të kujtuar një personalitet, një ngjarje, një situatë të caktuar në kontekstin e temës mësimore;
- vëzhgimin e materialeve të vendosura për të nxitur diskutimin apo për të verifikuar njohuritë e marra më parë.

Stili i të nxënësve dëgjimor, është kur nxënësi/ja e përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së dëgjimit. Këta nxënës përvetësojnë më mirë dhe më lehtë njohuritë nëpërmjet *incizimeve, bisedave, diskutimeve* ku bëhen vlerësime, jepen mendime, përfundime, bëhen analiza etj. Të nxënësve përmes dëgjimit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi/ja ku kërkohet përfshirja e nxënësve në:

- dëgjimin e muzikës apo një situatë në kontekstin e temës mësimore;
- biseda dhe diskutime në grup për prezantimin e punëve të ndryshme;
- veprimtari që kërkon të folur të rrjedhshëm dhe të qartë.

Stili i të nxënësve kinestetik, është kur nxënësi/ja përvetëson përmbajtjet mësimore në mënyrë aktive, duke vepruar, luajtur, shkruar, vizatuar etj. Këta nxënës janë më të suksesshëm nëse:

- e prekin dhe e ndiejnë përmbajtjen mësimore;
- i përdorin pjesët trupore dhe ndjenjat;
- përdorin gjuhën e ndjenjave.

Përmes stileve të të nxënësve, nxënësit/et zhvillojnë prirje dhe shkathtësi të ndryshme p.sh.: bashkëveprimi në lojëra të ndryshme muzikore, apo aktivitete në grup, performime muzikore dhe kërcimi në shfaqjet skenike, kërcim apo teatër, vëzhgime dhe analiza të veprave figurative, biseda dhe debate në lidhje me çështje të caktuara shkencore etj.

Të tria këto stile harmonizohen dhe ndihmojnë çdo mësimdhënës/e të planifikojë veprimtari të larmishme mësimore, duke përdorur mjaft teknika dhe metoda të mësimdhënies.

Tematikat dhe përmbajtjet mësimore janë të integruara në funksion të edukimit me muzikën dhe mësimin të muzikës.

Realizimi i këtyre përmbajtjeve, përmes veprimtarive të ndryshme muzikore ndihmon në njohjen, edukimin dhe kultivimin e nxënësve me vlerat muzikore më të spikatura të kulturës kombëtare shqiptare, por edhe ato botërore. Disa veprimtari muzikore që kanë të bëjnë me procesin e mësimin të muzikës ku ndihmojnë dhe stilet e të nxënësve janë:

- 1) *Mësimi i këngëve* bën pjesë në të tria stilet e të nxënësve: stili pamor, dëgjimor, por edhe kinestetik, sepse këngët duhet:
 - të mësohen (*dëgjimor*);

të këndohen duke respektuar të gjitha kërkesat e këndimit dhe repertorit të sugjeruar për t'u mësuar (*pamor – ndjekja me sy e takteve që jep mësuesi/ja*);

- të shoqërohet edhe me instrumente muzikore popullore, por edhe të perkusionit/Orf (kinestetike);
- të shoqërohet me lëvizje trupore (*kinestetike*).

- 2) Në fushën e *lojës me instrumente muzikore*, mësuesi/ja bashkëpunon dhe angazhon nxënësit/et në përdorimin e instrumenteve muzikore popullore shqiptare të ngjashme edhe me instrumentet e perkusionit/ORF për *shoqërimin e këngëve* që këndojnë.
- 3) *Dëgjimi muzikor* është veprimtari muzikore që bën pjesë në stilin e të nxënësve dëgjimor dhe kinestetik, sepse edukon përqendrimin dhe vëmendjen ndaj dëgjimit të muzikës, por synon edhe memorizimin e njohurive muzikore në përjetimin e muzikës, përmes veprave muzikore shqiptare dhe atyre botërore.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies për të përmbushur stilet e të nxënësve në muzikë janë të shumta, dhe i japin mundësinë çdo nxënësi/ja të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin muzikor dhe artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimi të muzikës do të thotë që nxënësit/et të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata zbulojnë, kuptojnë, krijojnë dhe performojnë muzikën nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike.

Disa teknika shumë efikase në orën e mësimi të muzikës janë *Brainstorming*, *Diagrami i Venit*, *Loja me role*, *Kllaster* etj.

VI.4 TEKNIKA TË MËSIMDHËNIES

VI.4.1 Në stilin e të nxënësve pamor dhe dëgjimor veçojmë edhe teknikën e kllasterit. **Kllasteri**, ose grupimi i mendimeve që, ndonjëherë, në literaturë emërtohet “harta e mendimeve”, është një teknikë që i nxit nxënësit/et të mendojnë për të krijuar lidhje midis njohurive dhe fakteve. Shërben si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të mësuarit, duke sjellë nga kujtesa njohuritë muzikore që ata kanë, por edhe për të plotësuar ato më tej gjatë fazave të tjera të orës mësimore.

VI.4.2 Rrjeti i diskutimit është një teknikë e mësimdhënies, gjatë së cilës bëhet organizimi grafik i informacionit. Kjo teknikë i bën nxënësit/et të jenë të vëmendshëm ndaj dëgjimit të veprave muzikore, për të kuptuar përmbajtjen muzikore të veprave dhe krahasuar ato. Përdoret në fazën e realizimit të kuptimit dhe të reflektimit. Sipas kësaj teknike, klasa ndahet në dy grupe (“Pro” dhe “Kundër”). Diskutimi midis grupeve vazhdon 15-25 minuta, sipas temës dhe mund të realizohet me nxënësit/e të çdo moshe.

VI.4.3 **Brainstorming-u**, është një veprimtari që bën pjesë në stilin pamor, por edhe dëgjimor, duke iu përshtatur lëndës së muzikës, sepse nëpërmjet vendosjes së një fjale kryesore apo fragmenti muzikor për dëgjim në CD, shërben si fillimi i një diskutimi në mësim për një problem të caktuar, i cili më pas vazhdon me metoda e teknika të tjera.

Qëllimi i përdorimit të *Brainstorming*-ut është të vërë në dukje sa më shumë ide, zgjidhje ose komente për një problem të dhënë. *Brainstorming*-u përdoret për të shprehur ide të reja me të gjithë klasën ose me një grup nxënësish dhe karakterizohet nga një lojë me përmasa të gjera dhe nga një intensitet i të shprehurit të larmishëm për gjëra të njohura.

Për shembull, nga programi i Edukatës muzikore 3 shkruhet në dërrasë të zezë fjala “Kor”, dhe u kërkohet të flasin rreth asaj që dinë mbi korin, numrin e personave që marrin këndojnë duke sjellë informacion që ata kanë për këtë njohuri.


Kjo teknikë kërkon të mbahet parasysh që:

- Asnjë prej zgjidhjeve e ideve të mos kritikohet.

- Të nxiten nxënësit/et të shprehin ide.
- Diskutimi të zhvillohet për gjëra të njohura.
- Të aktivizohen edhe nxënës të ndrojtur.
- Të shërbejë si nxehje e trurit.

VI.4.4 Tabela e koncepteve, është një teknikë që bën pjesë në **stilin dëgjimor**, një teknikë racionale për të organizuar informacionin muzikor përmes dëgjimit dhe krahasimit të disa veprave muzikore. Përdoret veçanërisht kur jepen njëkohësisht më shumë se një koncept a dukuri. Ndhmon së tepërmi të kuptuarit, përmes strukturimit të materialit, pas leximit dhe në realizmin e skemave të qarta, që sigurojnë qëndrueshmërinë e dijeve. Kjo teknikë përdoret me sukses në fazën e realizimit të kuptimit dhe reflektimit.

Tabela e koncepteve hartohet duke renditur konceptet apo njohuritë muzikore, që duhet të krahasohen dhe në kolona renditen tiparet apo karakteristikat mbi bazën e të cilave bëhet krahasimi i njohurive të ndryshme.



TIPARE DALLUESE	TË PËRBASHKËTAT	TIPARE DALLUESE
o _____	o _____	o _____
o _____	o _____	o _____

VI.4.5 Diagrami i Venit është teknikë që bën pjesë në stilin dëgjimor më anë të së cilit evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve muzikore, formave muzikore, ngjarjeve muzikore, kompozitorëve të ndryshëm, 2 periudhave muzikore etj. Diagrami i Venit ndërtohet me prerjen e dy a më shumë rathëve. Përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit, pothuajse në çdo orë mësimi. Nëpërmjet tij, nxënësit/et zbulojnë tipare të përbashkëta dhe veçori dalluese në varësi të specifikave të temës së mësimi, si dhe mbajnë qëndrime personale lidhur me to.

III. MATERIALE DHE BURIME MËSIMORE

Gjatë mësimi të muzikës për realizimin e kompetencave, mësimpldhënësi/ja përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi/ja i prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Ai përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon mjedisin e përshtatshëm për

aktivitete. Teknologjia ka një ndikim të madh në muzikë duke ndihmuar nxënësit/et/et të eksplorojnë këngë me tematikë të ndryshme, për të rinj, arie, mjuzikëll, vepra muzikore të ndryshme, duke zhvilluar aftësitë e tyre në njohjen më të plotë të muzikës.

Tekstet dhe materialet sigurojnë përmes përdorimit të tyre një qasje të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Me anë të medieve, detyrave dhe projekteve të ndryshme, nxënësve u krijohet mundësia të demonstrojnë apo të prezantojnë punët dhe krijimet e tyre.

Muzika studiohet përmes njohjes dhe përdorimit të mjeteve, materialeve, teknikave e procedurave specifike muzikore, p.sh: për dëgjim muzikor, shikim të shfaqjeve për ndjekjen e pjesëve muzikore, të këngëve përdoren magnetofoni, TV-ja, CD-ja dhe DVD-ja.

Përveç materialeve shfrytëzohen edhe burime mësimore si teksti shkollor, internet etj.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- *Mjetet audiovizive si:* TV, magnetofon, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.
- *Mjetet dëgjimore:* radio, magnetofon, etj.
- *Mjetet verbale, tekstet si:* tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit/es, fletoret e punës, katalogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve/eve dhe demonstruar vepra të ndryshme muzikore. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për muzikën. Ky plan është i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit/et/et në punët e tyre krijuese dhe performuese, si dhe në krijime të ndryshme.

- *Mjedisi mësimor* (klasa, kabinetet e muzikës etj.).

IV. KUPTIMI DHE INTERPRETIMI I SIMBOLEVE NË TEKSTIN E NXËNËSIT/ET: EDUKATË MUZIKORE 3

IV.1. Muzikë do të thotë të:

- Këndosh
- Dëgjosh
- Krijosh
- Çmosh
- Vlerësosh
- Marrësh pjesë në koncerte

Muzika ju shërben për të:

- dëgjuar tingullin, ritmin, fragment muzikor nga vepra muzikore, këngë dhe lojëra muzikore.
- zbuluar dhe krijuar me tingujt dhe ritmet muzikore.
- kënduar këngë dhe lojëra muzikore.
- çmuar dhe vlerësuar eksperiencën të reja në muzikë.

Këto eksperiencia do t'ju ndihmojnë për të çmuar dhe vlerësuar muzikën përreth jush. Por më e rëndësishmja është që ju të kuptoni se rrugët për të krijuar muzikë dhe për të kuptuar atë, janë të shumëllojshme. Muzika është një emocion që zhvillohet brenda jush dhe ju performoni me të.

Simboli në tekstin e nxënësit/ et	Kuptimi i simbolit si e gjejmë në tekst
	Dëgjoj këngën/ritualin/lojën muzikore/fragmente muzikore.
	Vizatoj Ngjyros
	Këndo
	Kërcej
	Luaj dhe krijoj
	Ligjëroj
	Ndjekim ritmin

PLANI VJETOR

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE

KLASA: TRETË

Lënda: Edukatë muzikore					NJËSITË MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE		Kontributi në rezultatet e të nxënët për kompetencat kryesore të shkallë
GJYSMËVJETORI I		GJYSMËVJETORI II					
PERIUDHA (I)	PERIUDHA (II)	PERIUDHA (III)	PERIUDHA (IV)				
Shtator-Tetor (9 orë)	Nëntor-Dhjetor (8 orë)	Janar-Shkurt-Mars (11 orë)	Prill-Maj-Qershor (9 orë)				
Këngë (4 orë)	Këngë (3 orë)	Këngë (3 orë)	Këngë (3 orë)				
	Krijime /plotësime (1 orë)	Krijime / plotësime (1 orë)	Krijime /plotësime (1 orë)				
Lojë muzikore (1 orë)		Lojë muzikore (1 orë)	Lojë muzikore (1 orë)				
Elemente bazike të gjuhës artistike (1orë)	Elemente bazike të gjuhës artistike (2 orë)						
		Llojet e muzikës (1 orë)	Institucionet artistike (1 orë)				
Instrumentet muzikore (1 orë)	Instrumentet muzikore (1 orë)						
Krijues dhe performues (1 orë)	Krijues dhe performues (1 orë)	Krijues dhe performues (1orë)	Krijues dhe performues (1 orë)				
		Profesione muzikore (1 orë)					
			Ngjarje artistike (1 orë)				
Planifikime për mësimdhënësin (1 orë)	Planifikime për mësimdhënësin (1 orë)	Planifikime për mësimdhënësin (3 orë)	Planifikime për mësimdhënësin (1 orë)				

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv	I.3.	
	I.9.	
	I.6.	
	II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ	
	II.3.	
	II.5.	
	II.7.	
	II.8.	
	III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm	
	III.1.	
III.2.		
III.5.		
IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv	IV.1.	
	IV.2.	
	IV.3.	
	IV.6.	
V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë	V.2.	
	V.4.	
	VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm	
	V1.1.	
V1.2.		
V1.3.		
V1.5.		

Njësitë mësimore	
1.1.	Zilja e shkollës
1.2.	Melodia ime
1.3.	Instrumentet e perkusionit
1.4.	Ankimi i grenzës
1.5.	Ritmi 2,3,4 goditje
1.6.	Dëgjoj muzikë
1.7.	Për mëmëdhenë
1.8.	Ngjyrosim instrumentet
1.9.	Pentagrami, çelësi, notat muzikore
1.10.	Hapa dollapa
1.11.	Luajmë me notat
1.12.	Erdhi Viti i Ri
1.13.	Ndërtoj instrumente muzikore
1.14.	Urim mësueses
1.15.	Gjatësia dhe pushimi
1.16.	Dëgjoj muzikë
1.17.	Profesionet në muzikë
1.18.	Ne jemi shqiponja
1.19.	Plotësojmë dhe argëtohem
1.20.	Lojë muzikore
1.21.	Duar të arta
1.22.	Dëgjoj muzikë
1.23.	Biçikleta
1.24.	Dëgjoj muzikë
1.25.	Plotësoj dhe argëtohem
1.26.	Drini
1.27.	Ngjarje artistike
1.28.	Kënga ime e parë
1.29.	Dëgjoj muzikë
1.30.	Ode e gëzimit
1.31.	Institucionet artistike
Orë e lirë	
Interpretojmë së bashku	

GJYSMËVJETORI I
PERIUDHA: (1- 2)
MUAJT: SHTATOR-TETOR/NËNTOR-DHJETOR
FUSHA E KURRIKULËS: ARTE
LËNDA MËSIMORE: EDUKATË MUZIKORE
KLASA: II

KONCEPETI I: KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE

TEMA I.1: KËNGË, LOJËRA MUZIKORE DHE KRIJIME MUZIKORE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.6 Respektimi i rregullave të komunikimit.

I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

II.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.

III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm

III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës-lojë.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.

IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.

V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.4. Shfaqje e empatisë për të tjerët.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I.1.1. Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi, sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, flutura, katrorë etj.).

I.1.2. Ritmizon vargje, ritme (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë).

I.1. 5. Lëviz dhe improvizon në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.

I.1. 6. Krijon ritme e melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik.

TEMA MËSIMORE: ELEMENTET BAZIKE TË GJUHËS ARTISTIKE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.7 Dhënia dhe pranimi i informacionin në mënyrë konstruktive.

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.

VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.5 Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për shoqërinë dhe për mjedisin.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

2.1. Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh., njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempon, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.

TEMA MËSIMORE: KRIJUES DHE PERFORMUES

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm

III.1 Mësimi për të mësuar/nxënë; vetorganizimi i të nxënit.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

IV.1 Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

3.1 Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).

TEMA MËSIMORE: INSTRUMENTET MUZIKORE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.

III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm

III.1 Mësimi për të mësuar/nxënë; vetorganizimi i të nxënit.

III.2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënit.

V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.4. Shfaqje e empatisë për të tjerët.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

III.1 Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).

PERIUDHA (I dhe II)							
MUAJT: SHTATOR-TETOR (9 orë)/NËNTOR-DHJETOR (8 orë)							
Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Temat mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Këngë	Nxënësi/ja: - Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimit instrumentale trajtojnë temën të ndryshme të përshatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.). - Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksioneve të mësimdhënësit/es dhe në mënyrë kreative. - Luan lojëra të thjeshta muzikore të shoqëruara me këngë të cilat kanë gjuhën shprehëse të përshatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjellura me lëvizje trupore, e me vegla muzikore fëmijërore dhe që trajtojnë temën të ndryshme, por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor etj.). - Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).	1.1.Zilja e shkollës	8 orë	Bisedë	Buletini i pjesëmarrjes	Njeriu dhe natyra, Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Edukatë muzikore, Edukato fizike, sporte dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi,	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, CD DVD
		1.2. Melodia ime		Diskutim	Portofoli i nxënësit/et		
		1.4.Ankimi i grenzës		Breinstorming			
		1.7. Për mëmëdhënë		Diagrama e Venit	Vlerësim i ndërsjellë		
Lojëra muzikore		1.10. Hapa dollapa		Punë në grupe	Punë individuale	Gjuhë angleze, Matematikë	
		1.12.Erdhi Viti i Ri				Cështjet ndërkurrikulare - Mbrojta e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvarësia - Edukimi për media	
		1.14. Urim mësuës					
		1.11.Luajmë me notat					

Krijim muzikor	- Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike. - Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëgjëzat etj. - Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-përgjigje muzikore etj.). - Këndon ose luan në instrumente fëmijërore ndonjë krijim origjinal të shkurtër (ritmik, melodik) me inkurajimin dhe ndihmën e mësimdhenësit.	1.2. Luajmë me ritmin	1 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Breinstorming Diagrama e Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit/et Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra, Gjyhe shqipe, Edukatë figurative, Edukatë muzikore, Edukata fizike, sporte dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi, Gjyhe angleze, Matematikë Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathhtëritë për jetë - Globalizimi dhe ndërvarësia - Edukimi për media	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, CD DVD
------------------------------	---	------------------------------	--------------	---	--	--	--

Elementet bazike të gjuhës artistike	- Përijeton dhe dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. - Njeh notacionin grafik për disa nga vetitë themelore të tingullit muzikor, (lartësitë dhe gjatësitë tingullore). - Dallon disa dukuri muzikore ritmike e melodike në këngët e kënduara dhe në veprat e dëguara.	1.5. Ritmi 2, 3, 4 goditje 1.9. Pentagrami, çelësi, notat muzikore 1.15. Gjatësia dhe pushimi	3 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Breinstorming Diagrama e Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit/et Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra, Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Edukatë muzikore, Edukata fizike, sporte dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë angleze, Matematikë Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvarësia - Edukimi për media	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, CD DVD
--	--	--	--------------	---	--	---	---

Instrumente muzikore	- Dallon ngjyrën tingëllore të instrumenteve muzikore (popullore dhe klasike) përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshatshme për moshën e tyre. - Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht. - Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale ricikluese dhe organike (marakas me oriz, misër, dajre te vogla etj.). - Dallon instrumentet për nga materiali ndërtues, burimi tingëllor (instrumentet e drunjta, të tunxhit, frymore me harqe etj.), mënyra e interpretimit, ansambleve që u përkasin etj.	1.3. Instrumentet e perkusionit 1.8. Ngjyrosim instrumentet 1.13. Ndërtojnë instrumente muzikore	3 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Breinstorming Diagrama e Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit/et Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra, Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Edukatë muzikore, Edukata fizike, sporte dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë angleze, Matematikë Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvlerësia	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, CD DVD
-----------------------------	--	--	-------	---	--	---	---

Krijues dhe performues	- Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë botërorë dhe lokalë.	1.6. Dëgjoj muzikë 1.16. Dëgjoj muzikë	2 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Breinstorming Diagrama e Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit/et Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra, Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Edukatë muzikore, Edukata fizike, sporte dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë angleze, Matematikë Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvlerësia - Edukimi për media	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, CD DVD
------------------------	--	---	-------	---	--	--	--

GJYSMËVJETORI II
PERIUDHA: (3)
MUAJT: JANAR-MARS
FUSHA E KURRIKULËS: ARTE
LËNDA MËSIMORE: EDUKATË MUZIKORE
KLASA: II

KONCEPETI I: KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE

TEMA I.1: KËNGËT, LOJËRA DHE KRIJIME MUZIKORE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.6 Respektimi i rregullave të komunikimit.

I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

I.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.

III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm

III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës-lojë.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.

IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.

V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.4 Shfaqje e empatisë për të tjerët.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I.1.1 Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, flutura, katrorë etj.).

I.1.2 Ritmizon vargje, ritme (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë).

I.1.5 Lëviz dhe improvizon në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.

I.1.6 Krijon ritme e melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik.

TEMA MËSIMORE: KRIJUES DHE PERFORMUES

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm

III.1. Mësimi për të mësuar/nxënë; vetorganizimi i të nxënit.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

3.1. Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).

TEMA MËSIMORE: LLOJET E MUZIKËS

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.4 Shfaqje e empatisë për të tjerët.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

3.1 Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike.

PERIUDHA (III)							
MUAJT: JANAR-SHKURT-MARS							
Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temë mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Këngët	Nxënësi/ja: - Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimit instrumentale trajtojnë temë të ndryshme të përshatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.). - Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative.	1.18.Ne jemi shqiponja	4 orë	Bisedë Diskutim	Buletini i pjesëmarrjes	Njeriu dhe natyra, Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Edukatë muzikore, Edukata fizike, sporte dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë angleze, Matematikë	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, CD DVD
		1.21.Duar të arta		Lojë me role Breinstorming	Portofoli i nxënësit/et Vlerësim i ndërsjellë	Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike	
		1.23.Biçikleta		Diagrama e Venit Punë në grupe		- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	
Lojëra muzikore	1.20.Lojë muzikore			Punë individuale		- Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvlerësia - Edukimi për media	

Krijime muzikore	- Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike. - Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëgjëzat etj. - Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-përgjigje muzikore etj.). - Këndon ose luan në instrumente fëmijërore ndonjë krijim origjinal të shkurtër (ritmik, melodik) me inkurajimin dhe ndihmën e mësimitdhënësit.	1.19. Plotësojmë dhe argëtohem	1 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Brainstorming Diagrama e Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit/et Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra, Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Edukatë muzikore, Edukata fizike, sporte dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë angleze, Matematikë. Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvarësia	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, CD DVD
-------------------------	--	--------------------------------	-------	---	--	---	---

Llojet e muzikës	- Identifikon muzikën e përshtatshme për ngjarjet dhe situatat e ndryshme.	1.17. Profesione në muzikë	1 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Breinstorming Diagrama e Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit/et Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra, Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Edukatë muzikore, Edukata fizike, sporte dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë angleze, Matematikë Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvlerësia - Edukimi për media	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, CD DVD
-------------------------	---	----------------------------	-------	---	--	---	---

Krijues dhe performues	- Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë botërore dhe lokalë. - Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve (p.sh muzikën vokale, instrumentale, muzikën orkestrale, muzikë për film etj.). - Identifikon llojet e institucioneve artistike (galeri, teatër, muze, salle koncertesh etj.) - Emërton disa (së paku 4 krijues, interpretues të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale e kombëtare muzikore.	1.22. Dëgjoj muzikë 1.24. Dëgjoj muzikë	2 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Breinstorming Diagrama e Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit/et Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra, Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Edukatë muzikore, Edukata fizike, sporte dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë angleze, Matematikë Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvlerësia - Edukimi për media	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, CD DVD
-------------------------------	---	--	-------	--	---	--	--

GJYSMËVJETORI	II
PERIUDHA:	(4)
MUAJT:	PRILL-QERSHOR
FUSHA E KURRIKULËS:	ARTE
LËNDA MËSIMORE:	EDUKATË MUZIKORE
KLASA:	II

KONCEPETI I: KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE

TEMA I.1: KËNGË DHE KRIJIME MUZIKORE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.6 Respektimi i rregullave të komunikimit.

I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

II. 3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.

III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm

III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës-lojë.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.

IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.

V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.4 Shfaqje e empatisë për të tjerët.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I.1.1. Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi, sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, flutura, katrorë etj.)

I.1.2. Ritmizon vargje, ritme (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë).

I.1. 5. Lëviz dhe improvizon në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.

I.1. 6. Krijon ritme e melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik.

TEMA MËSIMORE: KRIJUES DHE PERFORMUES

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm

III.1. Mësimi për të mësuar/nxënë; vetorganizimi i të nxënit.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

3.1. Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).

TEMA MËSIMORE: LLOJET E MUZIKËS

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

IV.1 Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.4. Shfaqje e empatisë për të tjerët.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

3.1 Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike.

PERIUDHA (IV)							
MUAJT: PRILL, MAJ, QERSHOR							
Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Këngë	Nxënësi/ja: - Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimit instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.).	1.26. Drini 1.28.Kënga ime e parë 1.30. Sa herë vjen qershori	3 orë	Bisedë Diskutim	Buletini i pjesëmarrjes	Njeriu dhe natyra, Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Edukatë muzikore, Edukata fizike, sporte dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë angleze, Matematikë	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, CD DVD
	- Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksioneve të mësimdhënësit/es dhe në mënyrë kreative.			Lojë me role Breinstorming Diagrama e Venit Punë në grupe Punë individuale	Portofoli i nxënësit/et Vlerësim i ndërsjellë	Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvlerësia - Edukimi për media	

Krijim muzikor	- Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike. - Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëgjëzat etj. - Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-përgjigje muzikore etj.). - Këndon ose luan në instrumente fëmijërore ndonjë krijim origjinal të shkurtër (ritmik, melodik) me inkurajimin dhe ndihmën e mësimmthënësit.	1.25.Plotësoj dhe argëtohem	1 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Breinstorming Diagrama e Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit/et Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra, Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Edukatë muzikore, Edukata fizike, sporte dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë angleze, Matematikë Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojta e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvlerësia - Edukimi për media	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, CD DVD
-----------------------	---	-----------------------------	-------	---	--	---	---

Krijues dhe performues	- Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë botërorë dhe lokalë përmes veprave muzikore që dëgjojnë.	1.29. Dëgjoj muzikë	1 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Breinstorming Diagrama e Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit/et Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra, Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Edukatë muzikore, Edukata fizike, sporte dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë angleze, Matematikë Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvarësia	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, CD DVD
-------------------------------	---	---------------------	-------	---	--	--	---

Lloje muzikore	- Identifikon muzikën e përshatshme për ngjarjet dhe situatat e ndryshme.	1.27. Ngjarje artistike	1 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Breinstorming Diagrama e Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit/et Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra, Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Edukatë muzikore, Edukata fizike, sporte dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë angleze, Matematikë. Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvarësia	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, CD DVD
-----------------------	--	-------------------------	-------	---	--	---	---

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Rezultati i të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe), sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). Këngët, meloditë dhe shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksioneve të mësimeve të mësimdhënësit/es dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. I.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës. IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF I.1.1 Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit. RNF I.1.5 Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Zilja e shkollës”			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - këndon këngë me tematika të larmishme (atdheu, familja, natyra, shoqëria, shkolla etj.); - shpreh emocionet e veta për këngën që këndon; - përjeton muzikën dhe përdor një fjalor të thjeshtë muzikor.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve: klasa, shok/shoqe, respekt.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit/et, duke u kërkuar atyre të përshkruajnë: shkollën e tyre, klasën, mësimdhënësit nxënësit/et që ata shikojnë dhe dëgjojnë në shkollë.

I diskutojnë ato me njëri-tjetrin.

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësimdhënësi fillon mësimin me një **brainstorming** ku vendoset një foto me pamjen e shkollës. Nxënësit/et nxiten të diskutojnë rreth ditës së parë të shkollës duke veçuar disa nga emocionet që kanë kaluar atë ditë.

Mësohet kënga “*Zilja e shkollës*”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënës.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD.
- procedura metodike; ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja.
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave.*
- përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Nxënësit/et mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj.

Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit/et:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth shkollës së tyre, shokëve që kanë në klasë dhe mësimdhënësit të tyre;
- prezantojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

ZILJA E SHKOLLËS

I

Din-don, din-din-don,
zilja jonë po na fton!
U hap shkolla, me shëndet
dhe në klasë na thërret.

II

Din-don, din-din-don,
le të dihet përgjithmon'
Se fletoret do t'i mbush,
plot me pesa, varg si rrush.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/et do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: këndimin e këngës pa gabime dhe me diksion të qartë;

N3: këndimin e këngës saktë ritmikiisht dhe melodikiisht;

N4: interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;

N4: interpretimin e këngës vetëm dhe në kor/grup.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Udhëzohen nxënësit/et për **vizatimin** e shkollës së tyre.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (shkollën/klasën/mësuesin/en/shokët)

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Rezultati i të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë pasi instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. I.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës. IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF I.1.1 Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit. RNF I.1.5 Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Melodia ime”			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - këndon këngë me tematika të larmishme (atdheu, familja, natyra, shoqëria, shkolla etj.); - shpreh emocionet e veta për këngën që këndon; - përjeton muzikën dhe përdor një fjalor të thjeshtë muzikor.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: E dukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve: melodi, muzikë, këngë, tinguj.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit/et, duke u kërkuar atyre të përshkruajnë: muzikën,, këngën, vallen, duke diskutuar se çfarë atyre u pëlqen më shumë, këngëtari i preferuar, muzika e preferuar etj. I diskutojnë ato me njëri-tjetrin.

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësimdhënësi fillon mësimin me një **brainstorming** ku vendoset një muzikë ritmike për dëgjim. Nxënësit/et nxiten të diskutojnë rreth muzikës që ata pëlqejnë, duke veçuar disa nga emocionet që kanë kaluar atë ditë.

Mësohet kënga “*Melodia ime*”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD.
- procedura metodike; ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja, me vesh nga nxënësit/et.
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike nëpentagram.
- përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave.*
- përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Nxënësit/et mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj.

Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit/et:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth shkollës së tyre, shokëve që kanë në klasë dhe mësimdhënësit të tyre;
- prezantojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

MELODIA IME

I

Më pëlqen melodia ime,
E këndoj me plot gëzime,
E ndiej ritmin në zemrën time.

Refreni

Zemra ime tik-tak më bën,
Melodia shpirtin ma qet'son,
Porsi uji që buron
Kënga ime të jehoj’.

II

Me shumë ëndje e këndoj
Dhe plot tinguj kur dëgjoj,
Energjin’ mua më shtojn’.

Refreni

Zemra ime tik-tak më bën...

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: këndimin e këngës pa gabime dhe me diksion të qartë;

N3: këndimin e këngës saktë ritmikiisht dhe melodikiisht;

N4: interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;

N4: nterpretimin e këngës vetëm dhe në kor/grup.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj. Udhëzohen nxënësit/et për **vizatimin** e shkollës së tyre.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (muzikën, këngën, kërcimin

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema: “Instrumentet muzikore”		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon ngjyrën tingëllore të instrumenteve kryesore muzikore (popullore dhe klasike) përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshtatshme për moshën e tyre. Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht. Dallon instrumentet për nga materiali ndërtues, burimi tingëllor (instrumentet të drunjtë, të tunxhit, frymore me harqe etj.)	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive. IV.1 Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke trasmentuar zotësitë që posedon. V.4 Shfaqje e bashkëndjesisë për të tjerët.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 3.1 Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Instrumentet e perkusionit”			
Fjalët kyçe: trokitës ziles, marakas, kastanjeta, pjatat.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - kupton rolin e instrumenteve perkusionit në shoqërimin e muzikës; - shpjegon materialin, tingëllimin e instrumenteve të perkusioni dhe mënyrën e përdorimit; - plotëson ushtrime me njohuritë që ka për instrumentet muzikore; - shoqëron me instrumentet e mësuara këngë apo lojëra muzikore.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Arte; Gjuhët dhe komunikimi Kuptimi e shpjegimi i instrumenteve dhe përdorimi i tyre në shoqërimin e këngëve dhe muzikës			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet diskutimit, ku mësimdhënësi kërkon të vëzhgojnë fotot në libër dhe flasin për instrumentin që njohin më mirë. Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta) Bëhet njohja me instrumentet e perkusionit, duke i përdorur dhe treguar konkretisht ato, që nxënësit/et të kuptojnë: - përbërjen; - mënyrën e përdorimit; - tingëllimit të tyre. Nxënësit/et njëri pas tjetrit ose në grup provojnë të kuptojnë tri elementet për të cilat po mësojnë instrumentet. Ata provojnë dhe përgjigjen duke bashkëbiseduar me njëri-tjetrin. Pastaj nxiten nxënësit/et të vizatojnë dhe njëkohësisht të flasin rreth punës së tyre. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (10 minuta) Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet e perkusionit duke diskutuar me ata: - Ku ndryshon pamja e instrumenteve të perkusionit që mësuat? - Çfarë tingulli lëshojnë ato? - Ku ndryshojnë ato nga njëra-tjetra?
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/et do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në: N2: kuptimin e rolit të instrumenteve të perkusionit në shoqërimin e këngëve, melodive dhe kërcimeve të ndryshme; N3: ngjyrosjen e instrumenteve të perkusionit, shpjegimin e materialit, tingëllimin e instrumentit dhe mënyrën e përdorimit; N4: shpjegimin e materialit, tingëllimin e instrumentit dhe mënyrën e përdorimit.
Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit/et të vazhdojnë punimin e tyre në shtëpi.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re për instrumentet e perkusionit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngë “Ankimi i Grenzës”		Rezultati i të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë pasi instruksioneve të mësimeve dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. I.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës. IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF I.1.1 Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit. RNF I.1.5 Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Këngë “Ankimi i Grenzës”			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: - diskuton lidhur me tekstin e këngës dhe përmbajtjes së saj; - këndon këngën ritmikiisht dhe melodikiisht; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - këndon vetëm dhe në grup.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore Fusha: Shkenca dhe natyra Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme: insekt, mjaltë, grenzë, bletë, dobishëm etj.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit/et, ku mësimdhënësi u kërkon nxënësve të shikojnë në dërrasë fjalët e shkruara: *grenza, blea, lulet*, dhe flasin rreth tyre, çfarë ata mendojnë respektohet dhe dëgjohet mendimi i gjithsecilit. Nxënësit/et flasin dhe japin disa përvoja nga përjetimet e tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “*Ankimi i grenzës*”, duke u mbështetur në *stilin dëgjimor* të të nxënës.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD.
- procedura metodike; ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja.
- mësimi i melodisë së këngës/me rrokje neutral.
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- përvetësimi i këngës/lojë: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave.*
- interpretimi artistic i këngës/lojë: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Ata këndojnë në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm, veprim dhe intonacion.

Përsëritja e këngës “*Ankimi i grenzës*”, dhe diskutimi rreth melodisë e tekstit.

Nxënësit/et mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

ANKIMI I GRENZËS

I

Një dit' grenza po ankohej
pse si blea nuk trajtohet.
Pse i bëjnë bletës shtëpi,
Grenzën nuk e do njeri.

II

Kam dhe vija, kam dhe fletë,
trupin e kam krejt si bletë.
Un' si blea fluturoj,
pse s'jam bletë, nuk e kuptoj?

III

Nëpër lule fluturoj,
nektar lulesh grumbulloj.
Mjaltin tim s'e ha njeri,
kjo më duket padrejtësi!
Refreni
Ti si blea je vërtet',
por ti bletës nuk i ngjet.
Blea mbush hojet me mjalt',
kurse ti i mbush me balt'.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: këndimin e këngës pa gabime dhe me diksion të qartë;

N3: këndimin e këngës saktë ritmikiisht dhe melodikiisht;

N4: interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;

N4: interpretimin e këngës vetëm dhe në kor/grup.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re dhe këndimi i këngës me ndjenjë dhe emocione duke shoqëruar me lëvizje trupore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor Tema: “Elementet bazikë të gjuhës artistike”		Rezultati i të nxënit të temës: Njeh notacionin grafik për disa nga vetitë themelore të tingullit muzikor, (lartësitë dhe gjatësitë tingullore) Dallon disa dukuri muzikore ritmike e melodike në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjua.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.7 Dhënia dhe pranimi i informacionin muzikor për tingujt në mënyrë konstruktive. III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore. VI.5 Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 2.1. Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh., njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të tyre.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Ritmi me dy, tre dhe katër goditje”			
Fjalët kyçe: ritëm, 2-3-4 goditje, theks i fortë, theks i butë.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - zbulon ritmin dhe theksin nëpërmjet fjalëve me 2,3,4 rrokje; - kupton ritmin me dy, tri dhe katër goditje që shikon në një model ritmik; - luan me ritmin me dy-tre-katër goditje, duke shkruar atë përmes simboleve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatëuzikore 3.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Edukatë fizike, sporte dhe shëndet Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme i koncepteve: ecje, marsh, vals.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese, interaktive dhe gjithëpërfshirëse ku mësimdhënësi kërkon që nxënësit të rrokëzojnë fjalë me 2-3-4 rrokje duke përcaktuar ku bie theksi i fjalës.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

- Nxiten nxënësit/et të plotësojnë në tekstin e tyre krijimin sipas kërkesave që jepen në tekst.
- Simbolet e sjella si shembull mund të ndryshohen nga vetë nxënësi/ja, por duhet që ato të japin kuptimin e ritmit dhe goditjeve.
- Ata ligjërojnë ritmin me dy-tre dhe katër goditje.
- Më pas, ata shoqërojnë krijimin me shuplaka ose një instrument me goditje.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë individuale (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi ritmin, imitojnë dhe ligjërojnë duke demonstruar kuptimin e ritmit.

U kërkohet nxënësve të përgjigjen rreth asaj që mësuuan duke shpjeguar:

- Me sa goditje e krijuan krijimin e tyre?
- Pse simboli i trekëndëshit është më i fortë se sa rrumbullaku?
- Ku ndryshojnë ato?

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

- zbulimin e ritmeve me dy goditje në mjedisin përreth;
- krijimin e një ushtrimi sipas ritmit me dy goditje, duke përdorur simbolet përkatëse;
- shpjegimin dhe ligjërimin e ushtrimit të krijuar;
- zotërimin e të gjitha kërkesave muzikore të mësipërme.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et të krijojnë modele të tjera ritmike me dy goditje.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (ritmit, ecjes marsh, ritmit në mjedisin përreth).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema: “Krijues dhe performues”		Rezultati i të nxënit të temës: Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve (p.sh. muzikën vokale, instrumentale, muzikën orkestrale, muzikë për film etj). Emërton disa (së paku 4 krijues) interpretues të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale e kombëtare muzikore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive. IV.1 Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke trasmentuar zotësitë që posedon. V.4 Shfaqje e empatisë për të tjerët.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 3.1 Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Dëgjoj muzikë”			
Fjalët kyçe: përjetim, dëgjim muzikor, instrumente muzikore.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - identifikon nëpërmjet dëgjimit llojin e melodisë që dëgjon <i>e trishtuar, e shpejtë, e ëmbël, e gëzueshme</i> ; - dëgjon dhe përcakton llojin muzikor që luhet kënga apo pjesa muzikore; - përjeton nëpërmjet arteve të tjera emocionin që i jep muzika; - krahason dhe përshkruan ndryshimin e muzikës sipas emocioneve që i shkaktohen.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha Arte: Edukatë figurative Përdorimi i koncepteve figurative (si ngjyrat, vija dhe forma) në realizimin e përjetimit muzikor nëpërmjet ngjyrosjes apo vizatimit.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese ku mësimdhënësi u kërkon nxënësve të flasin rreth muzikës apo një kompozitori që ata njohin më mirë.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Më pas vazhdohet me vendosjen për dëgjim të disa fragmenteve muzikore, duke i ftuar nxënësit/et të vizatojnë përjetimin e tyre për muzikën që dëgjojnë në sfond. Dëgjojnë tri fragmente muzikore dhe diskutojnë rreth karakterit me të cilën ato ekzekutohen.

Pjesët e vendosura nga kompozitorët e mëdhenj botërorë:

- “Stinët e vitit”, Jozef Hajden;
- “Kënga e Solvegut”, Eduard Grig;
- “Bilbili”, Zeqirja Ballata

Më pas, ata ftohen të vizatojnë portretin e kompozitorit të preferuar ose përjetimin sipas muzikës së ndjerë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (10 minuta)

Nxënësit/et bëjnë përfundimin e njohurive të marra duke diskutuar përjetimet muzikore nëpërmjet vizatimit dhe të shprehurit rreth asaj që ndjejnë për muzikën që dëgjuan.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: evidentimin e kompozitorit që i pëlqen më shumë nëpërmjet veprës muzikore;

N3: përjetimin nëpërmjet arteve të tjera (vizatimit), emocionin që i jep muzika;

N4: krahasimin dhe diskutimin në ndryshimin e muzikës sipas emocioneve që i shkaktohen.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et të dëgjojnë muzikë të llojeve të ndryshme dhe të shprehën emocionalisht rreth asaj që dëgjojnë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (përjetimin emocional rreth muzikës që dëgjojnë).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksioneve të mësimeve dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. II.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës. IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF I.1.1 Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit. RNF I.1.5 Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Këngë “Për mëmëdhenë”			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - këndon këngën në ritëm dhe intoncion; - përjeton tekstin dhe muzikën e këngës, duke interpretuar me ndjenje dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve: atdhe, mëmëdhe, Shqipëri, Kosovë.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Mësimi fillon me një veprimtari (**bisedë**) me nxënësit/et, duke u kërkuar atyre të tregojnë rreth këngëve patriotike që ata njohin dhe këndojnë më mirë. *Pse quhen këngë patriotike?* Ata veçojnë këngën që ata pëlqejnë tyë këndojnë në festën e 28 Nëntorit.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Mësojmë këngën “*Për mëmëdhenë*”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënës. Kujtohet rregullat e këndimit.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD.
- procedura metodike; ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja.
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave*
- përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Nxënësit/et mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)

Nxënësit/et:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth interpretimit solo dhe në grup;
- shpjegojnë me njëri-tjetrin dhe thonë pse u pëlqen kjo këngë.

PËR MËMËDHENË

I

Për mëmëdhenë, për mëmëdhenë,
Vraponi burra, se s'ka me prit'!
Të vdesim sot ne me besa-besë,
pranë flamurit të kuq q'u ngrit.

II

Pranë flamurit, pranë flamurit,
Me shpat' të zhveshun shqipëtarisht.
Për dheun e babës edhe të burrit,
Kemi me vdekun sot burrërisht.

Refreni

Eja mblidhuni këtu, këtu,
Eja mblidhuni këtu, këtu,
Eja, eja mblidhuni këtu, këtu
bashkë me ne!

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/esdo të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: këndimin e këngës me të tjerët;

N3: interpretimin e këngës, me ndjenjë dhe emocion;

N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et për dëgjimin (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema: “Instrumentet muzikore”		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon ngjyrën tingëllore të instrumenteve muzikore (popullore dhe klasike) përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshtatshme për moshën e tyre. Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive. IV.1 Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit, duke trasmentuar zotësitë që posedon. V.4 Shfaqje e bashkëndjesisë për të tjerët.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 3.1 Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Ngjyrosim në instrument muzikor”			
Fjalët kyçe: pjatat, ksilofoni, marakas, trokitësi i zileve.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - kupton rolin e instrumenteve muzikore në shoqërimin e muzikës; - shpjegon materialin, tingëllimin e instrumentit dhe mënyrën e përdorimit; - ngjyros instrumentet muzikore të preferuara; - përshkruan punimin e vet dhe të shokut.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet diskutimit, ku mësimdhënësi kërkon të vëzhgojnë fotot në libër dhe flasin për atë instrument që njohin më mirë.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Bëhet njohja me instrumentet muzikore duke i përdorur dhe treguar konkretisht ato, që nxënësit/et të kuptojnë:

- përbërjen;
- mënyrën e përdorimit;
- tingëllimit të tyre.

Pastaj, nxënësit/et nxiten të ngjyrosin instrumentin e preferuar dhe njëkohësisht të flasin rreth punës së tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet në përgjithësi duke diskutuar me ata:

- Ku ndryshon pamja e instrumenteve muzikore?
- Çfarë tingulli lëshojnë ato?
- Ku ndryshojnë ato nga njëri-tjetri?

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: kuptimin e rolit të instrumenteve muzikore në shoqërimin e këngëve dhe melodive.

N3: shpjegimin e materialit, tingëllimin e instrumentit dhe mënyrën e përdorimit.

N4: ngjyrosjen sipas dëshirës të instrumentit të preferuar muzikor.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et të vazhdojnë punimin e tyre në shtëpi.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re për instrumentet muzikore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik Tema: “Elementet bazike të gjuhës artistike”		Rezultati i të nxënit të temës: Njeh notacionin grafik për disa nga vetitë themelore të tingullit muzikor, (lartësitë dhe gjatësitë tingullore). Dallon disa dukuri muzikore ritmike e melodike në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjua.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.7 Dhënia dhe pranimi i informacionin muzikor për tingujt në mënyrë konstruktive. III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. IV. 3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore. VI. 5 Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 2.1 Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh., njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempon, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Pentagrami, çelësi i solit dhe notat muzikore”			
Fjalët kyçe: pentagrami, çelësi i solit.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - identifikon çelësin e solit dhe pentagramin; - lexon notat muzikore, në vija dhe në fusha; - ushtrohet duke shkruar çelësin e solit; dhe notat muzikore - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Edukatë figurative Përdorimi i njohurive mbi linjat duke përdorur linjën (vijën e lakuar).			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE


Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese, interaktive dhe gjithëpërfshirëse ku nxënësit/et identifikojnë figurën e pentagramit, çelësit të solit dhe notat muzikore në foto. Mësimdhënësi përmbledh disa nga përgjigjet e nxënësve.


Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Mësimi i njohurive të reja fillon duke shpjeguar përkufizimin e pentagramit dhe vendosjen e çelësit solit në pentagram.

Hapi I: Orientohen nxënësit/et se si të shkruajnë çelësin e solit korrekt.



Hapi II: Fillon me shpjegimin e notave muzikore, vendodhjen dhe shkrimin e tyre në pentagram.



Notat në **vija**



Notat në **fusha**



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi pentagramin, çelësin e solit dhe notat muzikore duke demonstruar kuptimin e njohurive të marra.

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: identifikimin e çelësit të solit, pentagramit dhe notave muzikore;

N3: ushtrimin duke shkruar çelësin e solit; dhe notat muzikore;

N4: leximin e notave muzikore, në vija dhe në fusha;

N4: ndarjen e përvojës së vet artistike me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et të krijojnë ushtrime të tjera me simbole të muzikës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Rezultati i të nxënit të temës: Luan lojëra të thjeshta muzikore të shoqëruara me këngë të cilat kanë gjuhën shprehëse të përshtatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjellura me lëvizje trupore, e me vegla muzikore fëmijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor etj.). Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. III.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës. IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF I.1.1 Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit. RNF I.1.5 Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Këngë “Hapa dollapa”			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - diskuton rreth këngëve lojë të mësuara më parë; - këndon këngën lojë në ritëm dhe intonacion; - interpreton këngë lojë me ndjenjë dhe emocion dhe inskenon atë; - këndon vetëm dhe në grup.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi Kuptimi dhe përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve: shkëmbim, aktivitet fizik, mik.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ku nxiten nxënësit/et të lexojnë tekstin e këngës lojë dhe pyeten: A kanë luajtur ndonjëherë kukamshfti? Kush është grupi që ka fituar? Si janë ndjerë në ato momente? Më pas shpjegohen rregullat e lojës:

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Çova një letër mu në postë”, duke u mbështetur në *stilin dëgjimor* të të nxënës.

Vendoset për dëgjim kënga/lojë dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës/lojë në CD.
- Procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- Demonstrimi i këngës/lojë nga mësimdhënësi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- Këndimi i këngës/lojë sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja.
- Mësimi i melodisë së këngës/lojë me rrokje neutral.
- Mësimi i frazave të melodisë së këngës/lojë me solmizim.
- Interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- Këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.

- Përvetësimi i këngës/lojë: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave*

- Interpretimi artistik i këngës/lojë: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Ata këndojnë në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës lojë në ritëm, veprim dhe intonacion.

Demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit/et:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth shkollës së tyre, shokëve që kanë në klasë dhe mësueses së tyre.
- Prezantojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse iu pëlqen kjo këngë/lojë.

HAPA-DOLLAPA!

I

Hapa-dollapa,
kush është fshehur mbrapa?
Hopa Albana,
dil se të kapa!

II

Hapa-dollapa,
te pema fshehur ti je,
të pash', të pash',
dil, pra, Albana!

Refreni

Genci, Ermira,
ja Beni, Zamira.
Të gjith' i gjeta,
mungon Çiljeta.
Genci, Ermira,
ja Beni, Zamira,
ja dhe Çiljeta,
të gjithë i gjeta!

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: këndimin e këngës me të tjerët;

N3: interpretimin e këngës, me ndjenje dhe emocion;

N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et për dëgjimin (disa herë të këngës/lojë) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Udhëzohen nxënësit/et të shkruajnë dhe dërgojnë një kartoline për njeriun më të dashur, dhe e dërgojmë atë në postë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (miqësinë, shokët, ndihmën).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: “Krijimet muzikore”		Rezultati i të nxënit të temës: Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike. Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjeegjezat etj. Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-pergjege muzikore etj). Këndon ose luan në instrumente fëmijërore ndonjë krijim origjinal të shkurtër (ritmik, melodik) me inkurajimin dhe ndihmën e mësime dhënësit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënit. III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 1. 6. Krijon ritme e melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik; RNF I. 7. Krijon lëvizje origjinale kreative sipas muzikës, tekstit letrar ose situatës së caktuar; (vallëzim, dramë) RNF I. 8. Krijon elemente origjinale në interpretimin e rolit të caktuar dhe paraqitjes skenike.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Luajmë me notat”			
Fjalët kyçe: ritëm, plotësim, model ritmik.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - Kupton ushtrimet muzikore të dhëna/ fjalëkryq dhe ushtrime; - plotëson vendet bosh në fjalëkryq dhe ushtrime; - prezanton krijimet e veta duke shpjeguar ato; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit/es, , Edukatë muzikore 3, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet lojës, ku mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të recitojnë 2 vjershat në librin e tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Hapi I

Nxënësit/et nxiten për plotësimin e ushtrimeve të paraqitura në tekstin e tyre ku duhet të shkruajnë emrin e notës në kutinë bosh.

Hapi II: Nxënësit/et ftohen të shkruajnë notat muzikore në pentagram.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: bashkëbisedim (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi ritmin, imitojnë dhe ligjërojnë duke demonstruar kuptimin e ritmit.

U kërkohet nxënësve të përgjigjen rreth asaj që zhvilluan në klasë me ushtrimet duke shpjeguar detyrat e realizuara përmes;

- plotësimeve të munguara në ushtrime,
- lidhjen me përgjigjen e saktë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: kuptimin e ushtrimeve muzikore të dhëna me emra të notave muzikore;

N3: plotësimin e vendeve bosh në ushtrime me notat muzikore.

N4: prezantimin e krijimeve të veta duke shpjeguar ato;

N4: ndarjen e përvojës së vet me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et plotësojnë ushtrimet sipas kërkesave të paraqitura.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Rezultati i të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksioneve të mësimeve dhe në mënyrë kreative..	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. I.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës. IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF I.1.1 Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit. RNF I.1.5 Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Këngë “Erdhi Viti i Ri”			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: - diskuton lidhur me tekstin e këngës dhe atdheut të vet; - këndon këngën ritmiki dhe melodiki; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - këndon vetëm dhe në grup.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme: “Festa”, “Dhurata”, “Duam njëri-tjetrin” etj.			

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit/et, ku mësimdhënësi u kërkon nxënësve të shikojnë në dërrasë fjalët e shkruara: *Krishtlindje, IViti i Ri, dhurata* dhe flasin rreth tyre, çfarë ata mendojnë respektohet dhe dëgjohet mendimi i gjithsecilit. Nxënësit/et flasin dhe japin disa përvoja nga festt e fundvitit.

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësojmë këngën “Erdhi Vit i Ri”, duke u mbështetur në *stilin dëgjimor* të të nxënësve.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD.
 - procedura metodike; ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
 - demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gadishmërisë për të mësuar këngën.
 - këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja.
 - mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
 - mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
 - interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
 - këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
 - përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave*
 - interpretimi artistic i këngës/lojë: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*
- Ata këndojnë në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm, veprim dhe intonacion.

(10 minuta)

Përsëritja e këngës “Erdhi Vit i Ri” dhe diskutimi rreth melodisë dhe tekstit. Nxënësit/et mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mVrë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

ERDHI VITI I RI!**I**

Dhe bredhat që zbardhojnë
Qëndisur me stoli,
Dhe lepujt lajmërojnë
Se erdhi Vit’ i Ri!

II

Dhe ne do ta besojmë
Se vjen me të vërtet’,
Kur grepat do t’takojnë
Në orën dymbëdhjet’.

Refreni

Ç’jan’ ata gaztorë
Që hidhen e lodrojnë?
Vitin që po vjen,
Duan ta takojn’.

Po ai plakush
Që ecën dal’ngadal’?
Është viti që po shkon,
Dhurata do na fal’.

Dhe bredhat që zbardhojnë
Qëndisur me stoli,
Dhe lepujt lajmërojnë
Se erdhi Vit’ i Ri!

Dhe ne do ta besojmë
Se vjen me të vërtet’,
Kur grepat do t’takojnë
Në orën dymbëdhjet’.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**Vlerësimi**

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: këndimin e këngës me të tjerët;

N3: interpretimin e këngës, me ndjenjë dhe emocion;

N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor;

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re dhe këndimi i këngës me ndjenjë dhe emocione duke shoqëruar me lëvizje trupore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema: “Instrumentet muzikore”		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht. Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale recikluese dhe organike (marakas me oriz, misër, dajre të vogla etj.). Dallon instrumentet për nga materiali ndërtues, burimi tingëllor (instrumentet e drunjta, të tunxhit, frymore me harqe etj.), mënyra e interpretimit, asambleve që u përkasin etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive. IV.1 Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke trasmentuar zotësitë që posedon. V.4 Shfaqje e bashkëndjesisë për të tjerët.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 3.1 Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Ndërtoj instrumente muzikore”			
Fjalët kyçe: instrument muzikor, materiale të riciklueshme, mjete pune.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - ndërton instrumentin muzikor duke shpjeguar rrugën që ndoqi; - luan me instrumentin muzikor të ndërtuar; - shoqëron me instrumentin e krijuar këngë dhe lojëra muzikore, vetëm dhe me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Arte, Edukatë figurative Përdorimi i materialeve të riciklueshme në jetën e përditshme dhe konkretisht në ndërtimin e një instrumenti muzikor.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet prezantimit të disa materialeve të riciklueshme që do të përdoren për ndërtimin e instrumentit muzikor si daullja dhe ksilofoni.

Mësimdhënësi vendos mbi tavolinë *mararakas dhe kastanjeta* dhe pyet nxënësit nga se përbëhen ato. Ata provojnë tingëllimin e tyre, prekin dhe kuptojnë përbërjen dhe materialin me të cilin janë ndërtuar.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Nxënësit fillojnë të ndërtojnë instrumentin e preferuar.

Pasi kanë mbaruar ndërtimin e instrumentit, luajnë me to duke shoqëruar një këngë të mësuar më parë.



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)

Nxënësit bëjnë përforcimin e njohurive të marra duke diskutuar në lidhje me punën dhe rezultatin e arritur në krijimin e instrumentit të tyre muzikor.

Vlerësimi i nxënësit/es:

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: ndërtimin e instrumentit muzikor duke shpjeguar rrugën që ndoqi;

N3: luajtjen me instrumentin muzikor të ritmeve të ndryshme me dy goditje;

N4: shoqërimin me instrumentin e krijuar të këngëve dhe lojërave muzikore vetëm dhe me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et të ndërtojnë me materiale të riciklueshme instrumente të thjeshta fëmijore.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (mbi instrumentet muzikore).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Rezultati i të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik(grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksioneve të mësimeve dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. I.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës. IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF I.1.1 Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit. RNF I.1.5 Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Këngë “Urim mësueses”			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - diskuton lidhur me tekstin e këngës lidhur me atdheun; - këndon këngën ritmikisht dhe melodikisht; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocione; - këndon vetëm dhe në grup.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme: <i>shkolla, klasa, nxënësit/et, mësuesit etj.</i>			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit/et, ku mësimdhënësi u kërkon nxënësve të shikojnë në dërrasë fjalët e shkruara:

Shkolla

Klasa

Nxënësit/et

Mësimdhënësi

7 Marsi

dhe të flasin rreth tyre. Gjatë diskutimit respektohet dhe dëgjohet mendimi i gjithsecilit.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Urim mësueses”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD.
- procedura metodike; ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja- me vesh nga nxënësit/et.
- mësimi i melodisë së këngës/lojë me rrokje neutral.
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave*
- interpretimi artistik i këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Ata këndojnë në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm, veprim dhe intonacion.

Nxënësit/et mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

URIM MËSUESES

I

Jam ende e vogël
e ndoshta s’ di
t’i rreshtoj fjalët
si kam dëshirë.

Refreni

Një tufë me lule
kam përgatit’,
mësuese e dashur,
për këtë dit’.

II

Në shenjë dashnie
du’ t’i dhuroj,
dy fjal’ nga zemra,
un’ t’i uroj.

Refreni

Faleminderit,
mësuesja jon’!
Në zemrat tona
do jesh gjithmon’.

Vlerësimi i nxënësit/es:

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: këndimin e këngës me të tjerët;

N3: interpretimin e këngës, me ndjenjë dhe emocion;

N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor;

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re dhe këndimi i këngës me ndjenjë dhe emocione duke shoqëruar me lëvizje trupore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik Tema: “Elementet bazike të gjuhës artistike”		Rezultati i të nxënit të temës: Përjeton dhe dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) ne këngët, lojërat dhe veprat muzikore qe ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. Njeh notacionin grafik për disa nga vetitë themelore të tingullit muzikor, (lartësitë dhe gjatësitë tingullore). Dallon disa dukuri muzikore ritmike e melodike në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjuara.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.7 Dhënia dhe pranimi i informacionin muzikor për tingujt në mënyrë konstruktive. III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore. VI.5 Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 2.1 Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh., njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempon, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Gjatësia dhe pushimi”			
Fjalët kyçe: pentagrami, çelësi i solit.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - identifikon gjatësinë dhe pushimet në muzikë; - zbaton gjatësinë e notës dhe pushimit; - ushtrohet duke shkruar notat muzikore përmes lojës; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Edukatë figurative Përdorimi i njohurive mbi linjat duke përdorur linjën (vijën e lakuar).			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese, interaktive dhe gjithëpërfshirëse ku nxënësit/et identifikojnë gjatësinë e fjalëve përmes rrokjeve të ndryshme. Mësimdhënësi përmbledh disa nga përgjigjet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Mësimi i njohurive të reja fillon duke shpjeguar zgjatjen/gjatësinë e vlerave të notave dhe pushimeve në muzikë.

Hapi I: Orientohen nxënësit/et se si të shkruajnë çelësin e solit korrekt.

Notat ndahen:	Emërtohen:	Pushimet:
	Nota e plotë ose 4/4	Pushimi i plotë
	Gjysmënota ose 1/2	Pushimi gjysëm
	Nota çerekëshe ose 1/4	Pushimi çerekësh
	Nota tetëshe ose 1/8	Pushimi tetësh

Hapi II: Ftohen nxënësit/et të luajnë me notat muzikore, përmes ndjekjes dhe ngjyrosjes së vijave që të çojnë drejt një note të caktuar.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi gjatësinë e notave dhe pushimeve, duke demonstruar kuptimin e njohurive të marra.

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: identifikimin e gjatësisë dhe pushimeve në muzikë;

N3: zbatimin e gjatësisë së notës dhe pushimit;

N4: ushtrimin e njohurive të marra duke shkruar notat muzikore përmes lojës

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et të krijojnë ushtrime të tjera me simbole të muzikës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema: “Krijues dhe performues”		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë botërorë dhe lokalë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I. 9. Inicimi i veprimeve konstruktive. II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.1. Mësimi për të mësuar/nxënë; vetorganizimi i të nxënit. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke trasmentuar zotësitë që posedon.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 3.1 Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Dëgjoj vepra muzikore”			
Fjalët kyçe: përjetim, dëgjim muzikor, instrumente muzikore.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - identifikon krijues dhe vepra e tyre nëpërmjet dëgjimit; - dëgjon dhe përcakton karakterin e muzikës që luhet kënga apo pjesa muzikore; - përjeton nëpërmjet arteve të tjera emocionin që i jep muzika; - krahason dhe përshkruan ndryshimin e muzikës sipas emocioneve që i shkaktohen.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha Arte: Edukatë figurative Përdorimi i koncepteve figurative (si ngjyrat, vija dhe forma) në realizimin e përjetimit muzikor nëpërmjet ngjyrosjes apo vizatimit.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese ku mësimdhënësi u kërkon nxënësve të flasin rreth muzikës apo një kompozitori që ata njohin më mirë.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Më pas, vendosim për dëgjim disa fragmente muzikore duke i ftuar nxënësit/et të vizatojnë përjetimin e tyre për muzikën që dëgjojnë në sfond. Dëgjojnë 2 fragmente muzikore dhe diskutojnë rreth karakterit dhe shpejtësisë me të cilën ato ekzekutohen.

Pjesët e vendosura nga kompozitorë të ndryshëm shqiptarë dhe kosovarë:

- *Duart e vogla* – Mark Kaçinari.
- Kënga “Pranvera në Kosovë”, Musa Piperku

Nxënësit/et vizatojnë sipas përjetimit emocional.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)

Nxënësit/et bëjnë përforcimin e njohurive të marra duke diskutuar përjetimet muzikore nëpërmjet vizatimit dhe të shprehurit rreth asaj që ndjejnë për muzikën që dëgjuan.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësit/et do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: evidentimin e muzikës që i pëlqen më shumë;

N3: përjetimin nëpërmjet arteve të tjera (vizatimit) të emocionit që i jep muzika;

N4: krahasimin dhe diskutimin e ndryshimit të muzikës sipas emocioneve që i shkaktohen.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et të dëgjojnë muzikë të llojeve të ndryshme dhe shprehën emocionalisht rreth asaj që dëgjojnë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (përjetimin emocional rreth muzikës që dëgjojnë).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Çmuarja dhe vlerësimi estetik dhe artistik Tema: “Lloje muzikore”		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon llojet e institucioneve artistike (galeri, teatër, muze, salle koncertale etj)	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke trasmentuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 3.3. Prezanton funksionin e disa institucioneve të ndryshme artistike.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Profesionet në muzikë”			
Fjalët kyçe: kompozitor, këngëtar, instrumentist, dirigjent.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - Evidenton karakteristikat e profesioneve në fushën e muzikës; - Shpreh mendimin e vet në lidhje me muzikën që interpreton instrumentisti/këngëtari/dirigjenti (x). - Shpreh mendimin e vet në lidhje me muzikën që krijon kompozitori (x). - Respekton mendimin e të tjerëve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Arte: Edukatë figurative Përdorimi i materialeve të riciklueshme në jetën e përditshme dhe konkretisht në ndërtimin e një instrumenti muzikor.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet prezantimit **konkretisht apo nëpërmjet fotove** të një studio të kompozitorit, interpretimit të një instrumentisti apo këngëtari. Nxiten nxënësit/et të flasën rreth asaj që shikojnë në foto.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Nxënësit/et bisedojnë në lidhje me figurat që ata shikojnë në tekst të cilat kanë të bëjnë me fushën e muzikës dhe ata që i përdorin ato si: kompozitori, instrumentisti, këngëtari apo dirigjenti.

Diskutojnë rreth tyre.

Më pas, ata vizatojnë sipas imaginatës apo ashtu sikurse e kanë parë në foto profesionistin që ata pëlqejnë më shumë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: (10 minuta)

Nxënësit/et diskutojnë rreth krijimeve të tyre duke respektuar mendimin dhe punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: evidentimin e karakteristikave të profesioneve në fushën e muzikës;

N3: shprehjen e mendimit të vet në lidhje me muzikën që interpreton instrumentisti/këngëtari/dirigjenti (x).

N4: shprehjen e mendimit të vet në lidhje me muzikën që krijon kompozitori (x).

N4: respektimin e mendimit të të tjerëve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et të vizatojnë në shtëpi punimin e tyre lidhur me objektet që përdoren në fushën e muzikës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (mbi profesionet në fushën e muzikës).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngë/ lojë		Rezultati i të nxënit të temës: Luan lojëra të thjeshta muzikore të shoqëruara me këngë të cilat kanë gjuhën shprehëse të përshtatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjellura me lëvizje trupore, e me vegla muzikore fëmijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor etj.). Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. I.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës. IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF I.1.1 Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit. RNF I.1.5 Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Këngë-lojë “Ne jemi dy shqiponja”			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - diskuton rreth këngëve-lojë të mësuara më parë; - këndon këngën-lojë në ritëm dhe intonacion; - interpreton këngë-lojë me ndjenjë dhe emocion dhe e inskenon atë; - njeh rregullat e këngës-lojë; - zbaton rregullat e këngës-lojë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Artet Përshkrimi i simboleve të shqiptarëve dhe vizatimi i shqiponjës, si simbol i tyre.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një gjithëpërfshirëse, ku mësimdhënësi u kërkon nxënësve kuptojnë rregullat e këngës-lojë.

Rregullat e lojës

Nxënësit/et ndahen në dy grupe dhe qëndrojnë përballë njëri-tjetrit, të kapur dorë për dore. Njëri grup këndon dy vargjet e para, duke iu drejtuar grupit që ka përballë. Më pas tërhiqet dhe pret grupin tjetër, që afrohet drejt tij, duke kënduar dy vargjet e tjera. Kështu vazhdon kënga-lojë deri në fund.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Ne jemi dy shqiponja”, duke u mbështetur në *stilin dëgjimor* të të nxënës.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës/lojë në CD.
- Procedura metodike; ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- Demonstrimi i këngës/lojë nga mësimdhënësi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- Këndimi i këngës/lojë sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja.
- Mësimi i melodisë së këngës/lojë me rrokje neutral.
- Mësimi i frazave të melodisë së këngës/lojë me solmizim.
- Interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- Këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- Përvetësimi i këngës/lojë: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave*
- Interpretimi artistic i këngës/lojë: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Ata këndojnë në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm, veprim dhe intonacion.

Ata këndojnë në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës-lojë në ritëm, veprim dhe intonacion.

Demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit/et:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth shkollës së tyre, shokëve që kanë në klasë dhe mësimdhënësit të tyre;
- prezantojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

NE JEMI SHQIPONJA

Gr. I: Ne jemi dy shqiponja.

Rum ti, rum ti, rum ti, rum la!

Gr. II: Çfar’ doni ju shqiponja?

Rum ti, rum ti, rum ti, rum la!

Gr. I: Ne duam më të shpejtën.

Rum ti, rum ti, rum ti, rum la!

Gr. II: Më të mirën dhe më trimen.

Rum ti, rum ti, rum ti, rum la!

Gr. I: Cila është m’ e mira?

Rum ti, rum ti, rum ti, rum la!

Gr. II: M’ e mira është Albana.

Rum ti, rum ti, rum ti, rum la!

Recitativi

Ti je trime, ti punëtore,
po shqiponjë është Albana!

Vlerësimi i nxënësit/es: Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në: N2: këndimin e këngës lojëme të tjerët; N3: Interpretimin e këngës, lojë me ndjenjë dhe emocion; N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor. N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).
Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit/et për dëgjimin (disa herë të këngës-lojë) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (mbi kafshët, dobinë e tyre, kujdesin ndaj tyre).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: “Krijimet muzikore”		Rezultati i të nxënit të temës: Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike. Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëegjëzat etj. Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-përgjigje muzikore etj). Këndon ose luan në instrumente fëmijërore ndonjë krijim origjinal të shkurtër (ritmik, melodik) me inkurajimin dhe ndihmën e mësimitdhënësit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënit. III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 1. 6. Krijon ritme e melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik; RNF I. 7. Krijon lëvizje origjinale kreative sipas muzikës, tekstit letrar ose situatës së caktuar; (vallëzim, dramë) RNF I. 8. Krijon elemente origjinale në interpretimin e rolit të caktuar dhe paraqitjes skenike.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Plotësojmë dhe argëtohemi”			
Fjalët kyçe: ritëm, plotësim, model ritmik, fjalëkryq.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - kupton ushtrimet muzikore të dhëna/fjalëkryq dhe ushtrime; - plotëson vendet bosh në fjalëkryq dhe ushtrime; - prezanton krijimet e veta duke shpjeguar ato; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit/es Edukatë muzikore 3, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet lojës, ku mësimezhënësi u kërkon nxënësve të thonë nëse kanë plotësuar ndonjë fjalëkryq.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Hapi I

Nxënësit/et nxiten për plotësimin e fjalëkryqeve të paraqitura në tekstin e tyre.


Hapi II: Nxënësit/et ftohen të shkruajnë notat muzikore në pentagram dhe t'i emërtojnë ato.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: bashkëbisedim (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi ritmin, imitojnë dhe ligjërojnë duke demonstruar kuptimin e ritmit.

U kërkohet nxënësve të përgjigjen rreth asaj që zhvilluan në klasë me ushtrimet, duke shpjeguar detyrat e realizuara përmes:

- plotësimeve të munguara në ushtrime,
- lidhjen me përgjigjen e saktë.



Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/esdo të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: Kuptimin e ushtrimeve muzikore të dhëna/ fjalëkryqet me emra të notave muzikore;

N3: plotësimin e vendeve bosh në fjalëkryqe dhe ushtrime;

N4: prezantimin e krijimeve të veta duke shpjeguar ato;

N4: ndarjen e përvojës së vet me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et plotësojnë fjalëkryqet duke u argëtuar përmes muzikës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngë/ lojë		Rezultati i të nxënit të temës: Luan lojëra të thjeshta muzikore të shoqëruara me këngë të cilat kanë gjuhën shprehëse të përshtatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjellura me lëvizje trupore, e me vegla muzikore fëmijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor etj). Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. I.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës. IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF I.1.1 Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit. RNF I.1.5 Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Lojë muzikore”			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, krijim muzikor.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - këndon këngë të mësuara më parë; - Plotëson melodinë e këngës në vendet bosh me nota dhe pushime; - Shpjegon zbatimin e lojës muzikore me nota dhe pushime.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet kujtimit të këngës “Mor bubreç” në ritëm dhe intonacion. Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta) Hapi I: Ftohen nxënësit/et të plotësojnë vijën melodike të këngës “Mor bubreç” duke plotësuar vendet bosh me nota dhe pushime. Varianti i parë i këngës “Mor Bubreç është” me fjalë poshtë saj. Hapi II: Ftohen nxënësit/et të plotësojnë vijën melodike të këngës “Mor bubreç” duke plotësuar vendet bosh me nota dhe pushime. Varianti i dytë i këngës “Mor Bubreç është pa fjalë poshtë saj. Demonstrimi i rezultateve të arritura Nxënësit/et: -diskutojnë me njëri-tjetrin rreth plotësimeve në lojën e tyre muzikore. Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në: N2: këndimin e këngës “Mor bubreç” të mësuara më parë; N3: plotësimin e melodisë së këngës në vendet bosh me nota dhe pushime; N4: shpjegimin dhe zbatimin e lojës muzikore me nota dhe pushime. N4: bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrës. Detyrat dhe puna e pavarur Udhëzohen nxënësit/et për zhvillimin e detyrës në shtëpi. Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Rezultati i të nxënit të temës: Këndon këngë e melodi të thjeshta (në grup). Shoqëron këndimin dhe/ose luan melodi të thjeshta me vegla muzikore ritmike e melodike të përshtatshme për fëmijë (p.sh. instrumentet e Orf-it).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. I.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës. IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF I.1.1. Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit. RNRNF I.1. 5. Lëviz dhe improvizon në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Këngë “Duar të arta”			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - diskuton lidhur me tekstin e këngës lidhur me atdheun; - këndon këngën ritmikisht dhe melodikisht; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - këndon vetëm dhe në grup.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme: dashuri, mirënjohje, respekt etj.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit/et, ku mësimdhënësi u kërkon nxënësve të shikojnë në dërrasë fjalët e shkruara:

Nëna

8 Marsi

Dhurata

Dashuri

Mirënjohje

dhe të flasin rreth tyre. Gjatë diskutimit respektohet dhe dëgjohet mendimi i gjithsecilit.

Ndërtimi i njohurive të reja 30 minuta

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Duar të arta” duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënësit.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD.
- procedura metodike; ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja.
- mësimi i melodisë së këngës/lojë me rrokje neutral.
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave*
- interpretimi artistik i këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Ata këndojnë në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm, veprim dhe intonacion.

Nxënësit/et mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

DUAR TË ARTA

I

Nëna ime e dashur
Duar t'arta ke,
Kur na përqafton
T'g'zuara jemi ne.

II

Un' të dua shumë,
Un' të dua shumë
Se ti na rrite
Bashk' me motrën time
Në këtë rrugë drite.

Vlerësimi i nxënësit/es:

Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:

- këndimin e këngës pa gabime dhe me diksion të qartë;
- këndimin e këngës saktë ritmikisht dhe melodikisht;
- interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;
- interpretimin e këngës vetëm dhe në kor/grup.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re dhe këndimi i këngës me ndjenjë dhe emocione duke shoqëruar me lëvizje trupore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema: “Krijues dhe performues”		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë botërorë dhe lokalë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke trasmentuar zotësitë që posedon. V.4. Shfaqje e bashkëndjesisë për të tjerët.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 3.1 Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Dëgjoj muzikë”			
Fjalët kyçe: përjetim, dëgjim muzikor, instrumente muzikore.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - identifikon nëpërmjet dëgjimit llojin e melodisë që dëgjon <i>e trishtuar, e shpejtë, e ëmbël, e gëzueshme</i> ; - dëgjon dhe përcakton llojin muzikor që luhet kënga apo pjesa muzikore; - përjeton nëpërmjet arteve të tjera emocionin që i jep muzika; - krahason dhe përshkruan ndryshimin e muzikës sipas emocioneve që i shkaktohen.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha Arte: Edukatë figurative Përdorimi i koncepteve figurative (si ngjyrat, vija dhe forma) në realizimin e përjetimit muzikor nëpërmjet ngjyrosjes apo vizatimit.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situate ndërvepruese ku mësimmshënësi u kërkon nxënësve të flasin rreth muzikës apo një kompozitori që ata njohin më mirë. Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta) Më pas, vendosim për dëgjim të disa fragmente muzikore duke i ftuar nxënësit/et të vizatojnë përjetimin e tyre për muzikën që dëgjojnë në sfond. Dëgjojnë 3 fragmente të ndryshme dhe diskutojnë rreth karakterit dhe shpejtësisë me të cilën ato ekzekutohen. Pjesët e vendosura nga kompozitorë të ndryshëm shqiptarë dhe kosovarë: • <i>Marshi Turk, Moxart.</i> • <i>Filmi Skëndërbeu, Çesk Zadeja.</i> • <i>Goca e Kaçanikut, Rauf Dhomi</i> Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta) Nxënësit/et bëjnë përforsimin e njohurive të marra duke diskutuar përjetimet muzikore nëpërmjet vizatimit dhe të shprehurit rreth asaj që ndjejnë për muzikën që dëgjuan.
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në: N2: evidentimin e muzikës që i pëlqen më shumë; N3: përjetimin nëpërmjet arteve të tjera (vizatimit) të emocionit që i jep muzika; N4: krahasimin dhe diskutimin e ndryshimit të muzikës sipas emocioneve që i shkaktohen.
Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit/et të dëgjojnë muzikë të llojeve të ndryshme dhe shprehën emocionalisht rreth asaj që dëgjojnë.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (përjetimin emocional rreth muzikës që dëgjojnë).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Rezultati i të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative..	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. I.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës. IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF I.1.1. Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit. RNF I.1. 5. Lëviz dhe improvizon në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Këngë “Biçikleta”			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - diskuton lidhur me tekstin e këngës; - këndon këngën ritmikisht dhe melodikisht; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - këndon vetëm dhe në grup.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme <i>dashuri, mirënjohje, respekt</i> ” etj.			

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit/et, ku mësimdhënësi u kërkon nxënësve të shikojnë në dërrasë fjalët e shkruara:

Patina, biçkletë, etj., dhe të flasën rreth tyre. Gjatë diskutimit respektohet dhe dëgjohet mendimi i gjithsecilit.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Biçikleta” duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënësve.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD
- procedura metodike; ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja.
- mësimi i melodisë së këngës/lojë me rrokje neutral.
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave*
- interpretimi artistik i këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Ata këndojnë në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm, veprim dhe intonacion. Nxënësit/et mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

BIÇIKLETA**I**

Tring-tring, tring-tring,
zilka tringëllon.
Vetëm me dy rrota edhe një
timon,
ikën biçikleta sikur fluturon.
Sa bukur Besniku
atë e drejton!

II

Tring-tring, tring- tring,
zilka tringëllon.
Veri biçikleta rrugëve kalon,
duket në asfalte sikur fluturon.
Sa bukur Valbona
atë e drejton!

Tring-tring, tring-tring,
zilka tringëllon!

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: këndimin e këngës pa gabime dhe me diksion të qartë;

N3: këndimin e këngës saktë ritmikiisht dhe melodikiisht;

N4: interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion, vetëm dhe në kor/grup.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re dhe këndimi i këngës me ndjenjë dhe emocione duke shoqëruar me lëvizje trupore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema: “Llojet e muzikës”		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri përmes dëgjimit muzikor (p.sh. muzikë për vallëzim, muzikë për film (vizatimor), muzikë për fëmijë, muzikë për raste të ndryshme, muzikë festive etj.) Identifikon muzikën e përshtatshme për ngjarjet dhe situatat e ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I. 9 Inicimi i veprimeve konstruktive.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 3. 1 Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve (p.sh. muzikën vokale, instrumentale, portretin, peizazhin etj.). RNF 4.1 Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Dëgjoj muzikë”			
Fjalët kyçe: përjetim, dëgjim muzikor, koncert.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: - identifikon nëpërmjet dëgjimit llojin e melodisë që dëgjon <i>e trishtuar, e shpejtë, e ëmbël, e gëzueshme</i>; - dëgjon dhe përcakton tempin muzikor që luhet kënga apo pjesa muzikore; - përjeton nëpërmjet arteve të tjera emocionin që i jep muzika; - krahason dhe përshkruan ndryshimin e muzikës sipas emocioneve që i shkaktohen.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Njeriu dhe natyra-shkenca, Shoqëria dhe mjedisi Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme mbi natyrën, kafshët dhe shpendët si dhe kujdesi ndaj tyre, respekti, mik, armik.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese dhe interaktive, ku mësimdhënësi u vendos nxënësve të dëgjojnë fragment muzikor nga vepra “Petja dhe ujku” Sergei Prokofjev për të diskutuar rreth saj. Ata diskutojnë rreth karakterit të muzikës që dëgjojnë dhe personazheve që e përbëjnë këtë muzikë, duke e shoqëruar me një foto.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Tregohet historia e veprës “Petja dhe ujku”.

Tregimi ka të bëjë me një djalë me emrin Petja (Pjetër, Pierino) i cili jeton me gjyshin e tij. Gjyshi nuk dëshiron që Petja të dalë nga kopshti i shtëpisë, sepse aty ka ujqër. Një ditë, Petja del jashtë portës së kopshtit dhe sheh një rosë duke notuar në një pellg të afërt. Rosa është duke folur me një zog të vogël dhe nuk e shikon një mace që afrohet.

Një ujku i uritur del nga pylli dhe macja ngjitet në një pemë për t'i shpëtuar ujkut, ndërsa rosën nuk mundi dhe ujku e han i uritur. Petja merr një litar dhe ngjitet mbi muret e kopshtit në një pemë, ndërsa zogu e huton ujkun duke fluturuar mbi kokën e tij, që Petja të fuste lakun dhe kapte ujkun. Gjuetarët dalin nga pyjet dhe duan të vrasin ujkun, por Petja i ndalon ata duke çuar ujkun në kopshtin zoologjik.

Pjesët e vendosura:

- *Peter – fragment muzikor.* Nxënësit/et dëgjojnë dhe përjetojnë muzikën duke u shprehur në lidhje me atë çka ata mendojnë rreth saj. Nxiten nxënësit/et të shprehen se ky fragment jep ndjesinë e një djali që do të bëjë çapkënllëqe; muzikë që herë është e shpejtë, herë e ngadaltë sipas situatës që ndodhet Peteri. Ky fragment krijon idenë e shkathtësisë dhe gëzimit.
- *Zogu – fragment muzikor.* Nxënësit/et dëgjojnë dhe përjetojnë muzikën duke u shprehur në lidhje me atë çka ata mendojnë rreth saj. Nxiten nxënësit/et të shprehen se ky fragment jep ndjesinë gazmore të shpejtësisë. Ky fragment krijon idenë e gëzimit, haresë dhe lumturisë.
- *Ujku – fragment muzikor.* Nxënësit/et dëgjojnë dhe përjetojnë muzikën duke u shprehur në lidhje me atë çka ata mendojnë rreth saj. Nxiten nxënësit/et të shprehen se ky fragment jep ndjesinë e marshit dhe një muzikë që duket sikur dikush vjen si triumfator. Ky fragment krijon idenë e fuqisë, por edhe të hiles.
- *Rosaku – fragment muzikor.* Nxënësit/et dëgjojnë dhe përjetojnë muzikën duke u shprehur në lidhje me atë çka ata mendojnë rreth saj. Nxiten nxënësit/et të shprehen se ky fragment jep ndjesinë e qetësisë, muzikë e ngadaltë.

Më pas, mësimdhënësi/ja i nxit nxënësit/et të vizatojnë një simbol që përkon ose përfaqëson për nxënësit/et një stinë të caktuar. Ai/ajo i nxit të flasin atë që ata dinë për çdo stinë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi emocionin dhe përjetimin në muzikë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: identifikimin nëpërmjet dëgjimit të llojit të melodisë që dëgjon *e trishtuar, e shpejtë, e ëmbël, e gëzueshme*;

N3: dëgjimin dhe përcaktimin me fjalët e veta të përjetimit emocional muzikor;

N4: krahasimin dhe diskutimin e ndryshimit të muzikës sipas emocioneve që i shkaktohen;

N4: zotërimin e të gjitha kërkesave muzikore të mësipërme.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et të dëgjojnë muzikë të llojeve të ndryshme dhe shprehen emocionalisht rreth asaj që dëgjojnë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (përjetimin emocional rreth muzikës që dëgjojnë).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: “Krijimet muzikore”		Rezultati i të nxënit të temës: Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike. Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjeegjezat etj. Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-përgjigje muzikore etj). Këndon ose luan në instrumente fëmijërore ndonjë krijim origjinal të shkurtër (ritmik, melodik) me inkurajimin dhe ndihmën e mësimitdhënësit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënit. III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 1. 6. Krijon ritme e melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik; RNF I. 7. Krijon lëvizje origjinale kreative sipas muzikës, tekstit letrar ose situatës së caktuar; (vallëzim, dramë) RNF I. 8. Krijon elemente origjinale në interpretimin e rolit të caktuar dhe paraqitjes skenike.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Plotësoj dhe argëtohem”			
Fjalët kyçe: harta e Kosovës, nota muzikore.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - Kupton ushtrimet muzikore të dhëna/ plotësime; - plotëson vendet bosh me nota muzikore në ushtrim; - prezanton krijimet e veta duke shpjeguar ato; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit/es, Edukatë muzikore, klasa 3, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkenca dhe shoqëria; Gjuhët dhe komunikimi			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet lojës ku mësime të mëparshme u kërkon nxënësve të thonë emrat e qyteteve të Kosovës. Ai përmend Prishtinën dhe nxënësit/et fillojnë të plotësojnë me emra të tjerë.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Hapi I

Nxënësit/et nxiten për plotësimin e hartës së shtetit të Kosovës me nota muzikore, duke u argëtuar përmes postierit që çon notën në qytete të ndryshme.

Hapi II: Nxënësit/et ftohen të gjejnë emrin e notës që përkon me dy gërmat e para të emrit të figurës që shikojnë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: bashkëbisedim (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi ritmin, imitojnë dhe ligjërojnë duke demonstruar kuptimin e ritmit.

U kërkohet nxënësve të përgjigjen rreth asaj që zhvilluan në klasë me ushtrimet duke shpjeguar detyrat e realizuara përmes:

- plotësimeve të munguara në ushtrime,
- lidhjen me përgjigjen e saktë.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: kuptimin e kërkesave të ushtrimeve muzikore duke i plotësuar;

N3: plotësimin e vendeve bosh me nota muzikore në ushtrim;

N4: prezantimin e krijimeve të veta duke shpjeguar ato;

N4: ndarjen e përvojës së vet me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et plotësojnë ushtrimet, duke u argëtuar përmes muzikës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Rezultati i të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksioneve të mësimeve dhe në mënyrë kreative..	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. I.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës. IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF I.1.1. Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit. RNF I.1. 5. Lëviz dhe improvizon në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Këngë “Drini”			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - diskuton lidhur me tekstin e këngës lidhur me atdheun; - këndon këngën ritmikisht dhe melodikisht; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - këndon vetëm dhe në grup.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore, klasa 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme <i>lumi, kujdesi për lumenjtë, mjedisi</i> ” etj.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit/et, ku mësimdhënësi u kërkon nxënësve të shikojnë në dërrasë fjalët e shkruara:

Mjedisi, lumenjtë, pyjet, kujdesi për to, etj., dhe të flasim rreth tyre.

Gjatë diskutimit respektohet dhe dëgjohe mendimi i gjithsecilit.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Drini” duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD.
- procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gadishmërisë për të mësuar këngën.
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja.
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave.*
- interpretimi artistik i këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.* Ata këndojnë në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm, veprim dhe intonacion.

Ata këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

DRINI**I**

O Drin i kulluar
I vendlindjes sime,
Lum për uj'rat tua
T'bardha si agime!
Tepër unë të dua,
Un' dakol'i yt
Që me mijra herë
Në ty kam ra shyt.

II

Shtratit tënd ti ecën
Dal' e me ngadalë,
Prej shkëlqimesh
T'duket shkuma
Në çdo valë.
Prej brigjeve dukesh
Lumi paqelira,
Kah ecën laqe-laqe
Me uj'ra të dlira.

Vlerësimi i nxënësit/es:

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: këndimin e këngës pa gabime dhe me diksion të qartë;

N3: këndimin e këngës saktë ritmikiisht dhe melodikiisht;

N4: interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion, vetëm dhe në kor/grup.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et për dëgjimin (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re dhe këndimi i këngës me ndjenjë dhe emocione duke shoqëruar me lëvizje trupore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tetë)
Konceptet: Çmuarja dhe vlerësimi estetik dhe artistik Tema: “Vepra dhe ngjarje muzikore”		Rezultati i të nxënit të temës: Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjate bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera artistike etj. Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të të tjerëve me fjalor e terma adekuate. Krijon shprehi për dëgjim të vazhdueshëm të veprave muzikore dhe për muzikim Përshkruan dhe komenton (me forma të ndryshme shprehëse: me gojë, me shkrim, me shprehje figurative, etj.) ndonjë ngjarje muzikore artistike të përjetuar në familje, në shkollë, koncert, nga TV etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8 Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1 Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke trasmentuar zotësitë që posedon. V.2 Dëshmim i vetëbesimit. VI.4 Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF IV.1. Çmon dhe vlerëson krijimet dhe performancat artistike (vetanake dhe të të tjerëve) duke përdorur terminologji adekuate dhe konceptet e fushës. RNF IV.2. Komenton veprat artistike dhe shquan elementet karakteristike shprehëse të përdorura p.sh. ky vizatim është i mirë, ose forma e pemës nuk është mirë, për shkak se... ai/ajo këndoi mirë me ritëm, por melodia nuk ishte e saktë etj. Mua nuk më pëlqen që ke përdorur me tepri ngjyrën x, sepse... pra me gjykim kritik për aq sa lejon.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Ngjarje artistike”			
Fjalët kyçe: institucion artistik, muzeu, galeria, cirku, teatri, teatri i kukullave, opera.			

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - identifikon institucionet muzikore nëpërmjet pamjes apo përjetimit konkret; - merr pjesë në ngjarje të ndryshme artistike muzikore kombëtare dhe botërore; - grumbullon material për ngjarje muzikore apo institucione artistike muzikore; - ndan njohuritë e veta me të tjerët.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit/es Edukatë muzikore 3, CD, mjete të tjera për të punuar.
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
<i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)</i> Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese përmes brainstorming (foto/postera/filmime), ku mësuesi/ja nxit nxënësit/et të flasin në lidhje me ngjarje muzikore brenda dhe jashtë vendit ku ata kanë marrë pjesë apo kanë parë si dhe institucione muzikore që kanë qenë apo kanë parë në dokumentarë. Nxënësit/et diskutojnë në lidhje me të të dhe dëgjojnë mendimin e njëri-tjetrit.
<i>Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)</i> - Jepen disa aktivitete muzikore të kryera në Kosovë dhe Shqipëri dhe nxënësit/et gjejnë në hartë qytetin ku është kryer aktiviteti. - Mësimdhënësi/ja nxit më shumë diskutimin lidhur me ngjarjen, qytetin etj. - Nxiten për kërkimin dhe gjetjen e informacioneve shtesë mbi institucionet dhe ngjarje muzikore që ju kanë lënë mbresa nga <i>interneti</i>, dhe sjellin prezantimin e tyre në klasë.
<i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur (10 minuta)</i> Përsëritin njohuritë e marra mbi institucionet artistike dhe profesionet në fushën e muzikës.
<i>Vlerësimi</i> Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në: N2: identifikimin e institucioneve muzikore nëpërmjet pamjes apo përjetimit konkret; N3: marrin pjesë në ngjarje të ndryshme artistike muzikore kombëtare dhe botërore; N4: grumbullimin e materialit për ngjarje muzikore apo institucione artistike muzikore;
Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit/et të flasin reth institucionit artistik që ata njohin ose kanë marrë pjesë në shfaqje.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Rezultati i të nxënit të temës: Këndon këngë e melodi të thjeshta (në grup). Shoqëron këndimin dhe/ose luan melodi të thjeshta me vegla muzikore ritmike e melodike të përshtatshme për fëmijë (p.sh. instrumentet e Orf-it).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. I.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës. IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF I.1.1. Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit. RNF I.1. 5. Lëviz dhe improvizon në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Këngë “Kënga ime e parë”			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - diskuton lidhur me tekstin e këngës; - këndon këngën ritmikisht dhe melodikisht; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - këndon vetëm dhe në grup.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme muzikë, instrument muzikor, nota muzikore etj.			

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit/et, ku mësimdhënësi u kërkon nxënësve të shikojnë në dërrasë fjalët e shkruara *notat muzikore, violina, instrument muzikor, muzika etj.* dhe të flasin rreth tyre. Gjatë diskutimit respektohet dhe dëgjohet mendimi i gjithsecilit.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Mësojmë këngën “Duar të arta” duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD.
- procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi/ja dhe krijimi i gadishmërisë për të mësuar këngën.
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja.
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutrale.
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave.*
- interpretimi artistik i këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Ata këndojnë në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm, veprim dhe intonacion.

Nxënësit/et mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

KËNGA IME E PARË**I**

Sa herë marr violinën,
ndiej një gaz në zemër.
Por nuk është e lehtë
që të thurësh këngë.

II

Dal'ngadalë do rritem,
gishtat përmbi tela,
melodi të reja
do këndojë violina.

Refreni

Fa, mi, re, la, mi, re, re!
Ja kënga ime e parë
me tinguj, tinguj plot hare!
Çel si një pranver'
mbi male, fusha në atdhe,
violina do këndojë
si mijëra zogj cicërojnë
Mi, fa, sol, fa, mi, re!

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**Vlerësimi**

Vlerësimi i nxënësit/esdo të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: këndimin e këngës pa gabime dhe me diksion të qartë;

N3: këndimin e këngës saktë ritmikiisht dhe melodikiisht;

N4: interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion, vetëm dhe në kor/grup.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re dhe këndimi i këngës me ndjenjë dhe emocione duke shoqëruar me lëvizje trupore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema: “Krijues dhe performues”		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë botërorë dhe lokalë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF III.1 Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mëimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.). RNF III.2 Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike. RNF III.3 Prezanton funksionin e disa institucioneve të ndryshme artistike. RNF III.4 Dallon, krahason dhe prezanton krijues, performues dhe formacione interpretuese të zhanreve dhe stileve të ndryshme artistike në nivel kombëtar dhe global.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Dëgjoj muzikë”			
Fjalët kyçe: përjetim, dëgjim muzikor, emocion.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - identifikon nëpërmjet dëgjimit llojin e melodisë që dëgjon <i>e trishtuar, e shpejtë, e ëmbël, e gëzueshme</i>; - dëgjon dhe përcakton llojin muzikor që luhet kënga apo pjesa muzikore; - përjeton nëpërmjet arteve të tjera emocionin që i jep muzika; - krahason dhe përshkruan ndryshimin e muzikës sipas emocioneve që i shkaktohen.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore 3, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha Arte: Edukatë figurative Përdorimi i koncepteve figurative (si ngjyrat, vija dhe forma) në realizimin e përjetimit muzikor nëpërmjet ngjyrosjes apo vizatimit.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese ku mësuesi u kërkon nxënësve të flasin rreth muzikës apo një kompozitori që ata njohin më mirë.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Më pas, dëgjohen disa fragmente muzikore duke i ftuar nxënësit/et të vizatojnë përjetimin e tyre për muzikën që dëgjojnë në sfond. Dëgjojnë 3 fragmente të ndryshme dhe diskutojnë rreth karakterit dhe shpejtësisë me të cilën ato ekzekutohen.

Pjesët e vendosura nga kompozitorë të ndryshëm shqiptarë dhe kosovarë:

- “Nina nana” e Franc Shubert;
- “Atdheu im” e Bedrih Smetana;
- Nxënësve u kërkohet të vizatojnë përjetimin emocional.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (10 minuta)

Nxiten nxënësit/et të bëjnë përfundimin e njohurive të marra duke diskutuar përjetimet muzikore nëpërmjet vizatimit dhe të shprehurit rreth asaj që ndjejnë për muzikën që dëgjuan.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N 2: evidentimin e muzikës që i pëlqen më shumë;

N 3: përjetimin nëpërmjet arteve të tjera (vizatimit) të emocionit që i jep muzika;

N 4: krahasimin dhe diskutimin e ndryshimit të muzikës sipas emocioneve që i shkaktohen.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et të dëgjojnë muzikë të llojeve të ndryshme dhe shprehin emocionet rreth asaj që dëgjojnë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (përjetimin emocional rreth muzikës që dëgjojnë).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tretë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngë		• Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe), sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). • Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. I.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës. IV.6. Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF I.1.1. Këndon këngë dhe melodi të thjeshta, sipas imitimit. RNFI.1.5. Lëviz dhe improvizon në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin karakterin shprehës të muzikës etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Këngë “Odë gëzimi. - Himni Evropian”			
Fjalët kyçe: Tekst i këngës, melodi, interpretim			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: - Diskuton lidhur me tekstin dhe melodinë e këngës; - Këndon këngën ritmikisht dhe melodikisht; - Interpretin këngën me ndjenjë dhe emocion; - Shpreh emocionet e veta për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë muzikore, klasa 3, CD, magnetofon			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Artet Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve “Himn”, “Evropë,” Vendodhja gjeografike.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Hapi I: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit, duke u kërkuar atyre të tregojnë në hartë se ku ndodhet Evropa. Më pas ata veçojnë shtete ku ata kanë familjarë të tyre që jetojnë, shkollohen dhe punojnë. I diskutojnë mendimet me njëri-tjetrin.			

Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Himni i Evropës”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënësve. Kujtohen rregullat e këndimit.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në Cd
- Procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- Demonstrimi i këngës nga mësuesi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- Këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga Cd – me vesh nga nxënësit.
- Mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutrale.
- Mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- Interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- Këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- Përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave
- Përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Hapi III: Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)**Nxënësit:**

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth interpretimit solo dhe në grup;
- shpjegojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse u pëlqen kjo këngë.”

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive në:

N2: këndimin e këngës vetëm dhe me të tjerët, pa gabime dhe me diskion të qartë;

N3: Këndimin e këngës saktë ritmiki dhe melodiki;

N4: Interpretimin e këngës, me ndjenjë dhe emocion, vetëm dhe në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

ODE GËZIMI**I**

G’zim ti je i mrekullu’shëm
gjithmon’ jetën ti stolis,
n’pragun tënd, o të magjishëm
gjithmonë jetën ti stolis.

Refreni

Se atë që mbytt mërzia,
ti sërish e gjallëron.
V’llazërohet njerëzia,
flatra jote ku pushon.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 3 (tetë)
Konceptet: Çmuarja dhe vlerësimi estetik dhe artistik Tema: “Vepra dhe ngjarje muzikore”		Rezultati i të nxënit të temës: Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjate bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera artistike etj. Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të të tjerëve me fjalor e terma adekuate. Krijon shprehi për dëgjim të vazhdueshëm të veprave muzikore dhe për muzikim Përshkruan dhe komenton (me forma të ndryshme shprehëse: me gojë, me shkrim, me shprehje figurative, etj.) ndonjë ngjarje muzikore artistike të përjetuar në familje, në shkollë, koncert, nga TV etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8 Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1 Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke trasmentuar zotësitë që posedon. V.2 Dëshmim i vetëbesimit. VI.4 Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF IV.1. Çmon dhe vlerëson krijimet dhe performancat artistike (vetanake dhe të të tjerëve) duke përdorur terminologji adekuate dhe konceptet e fushës. RNF IV.2. Komenton veprat artistike dhe shquan elementet karakteristike shprehëse të përdorura p.sh. ky vizatim është i mirë, ose forma e pemës nuk është mirë, për shkak se... ai/ajo këndoi mirë me ritëm, por melodia nuk ishte e saktë etj. Mua nuk më pëlqen që ke përdorur me tepri ngjyrën x, sepse... pra me gjykim kritik për aq sa lejon.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Institucionet artistike”			
Fjalët kyçe: institucion artistik, muzeu, galeria, cirku, teatri, teatri i kukullave, opera.			

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- identifikon institucionet muzikore nëpërmjet pamjes apo përjetimit konkret;
- merr pjesë në ngjarje të ndryshme artistike muzikore kombëtare dhe botërore;
- grumbullon material për ngjarje muzikore apo institucione artistike muzikore;
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit/es Edukatë muzikore 3, CD, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese përmes **brainstorming (foto/postera/filmime)**, ku mësuesi/ja nxit nxënësit/et të flasin në lidhje me ngjarje muzikore brenda dhe jashtë vendit ku ata kanë marrë pjesë apo kanë parë si dhe institucione muzikore që kanë qenë apo kanë parë në dokumentarë.

Nxënësit/et diskutojnë në lidhje me të të dhe dëgjojnë mendimin e njëri-tjetrit.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

- Jepen disa aktivitete muzikore të kryera në Kosovë dhe Shqipëri dhe nxënësit/et gjejnë në hartë qytetin ku është kryer aktiviteti.
- Mësimdhënësi/ja nxit më shumë diskutimin lidhur me ngjarjen, qytetin etj.
- Nxiten për kërkimin dhe gjetjen e informacioneve shtesë mbi institucionet dhe ngjarje muzikore që ju kanë lënë mbresa nga *interneti*, dhe sjellin prezantimin e tyre në klasë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi institucionet artistike dhe profesionet në fushën e muzikës.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për demonstrimin e aftësive të arritura në:

N2: identifikimin e institucioneve muzikore nëpërmjet pamjes apo përjetimit konkret;

N3: marrin pjesë në ngjarje të ndryshme artistike muzikore kombëtare dhe botërore;

N4: grumbullimin e materialit për ngjarje muzikore apo institucione artistike muzikore;

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et të flasin rreth institucionit artistik që ata njohin ose kanë marrë pjesë në shfaqje.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

Referenca

- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2011.
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Kurrikula Bërthamë (Klasat 0, I, II, III, IV dhe V) (e rishikuar), 2016.
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Plani dhe programi lëndor për klasën e tretë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Udhëzues për zbatimin e kurrikulës për klasën përgatitore dhe arsimin e mesëm të ulët, 2014.
- <https://www.dreamstime.com/>

